

NAMIK DOKLE  
**COVID - 1984**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



NAMIK DOKLE

# COVID - 1984

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-376-25-1

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

[www.toena.al](http://www.toena.al)

Kemi dy jetë dhe e dyta  
fillon atëherë kur e kuptojmë  
që kemi vetëm një.  
*Konfuci*



Një muajin e shtatë të shfaqjes së sëmundjes, një burrë u hodh nga ballkoni i katit të tretë të spitalit. Të gjithë ata që e panë të shtrirë mbi pllakat e anërrugës së ndërtesës, i ngulën sytë jo mbi pllangën e stërmadhe të gjakut, por te masa e shkapërderdhur e trurit, që dukej si akullore e hedhur në tokë nga një fëmijë idhnak.

U mbloodhën shumë të sëmurë të tjerë për të parë, por një mjeke që erdhi aty nxitimthi, hoqi bluzën e saj të bardhë dhe e mbuloi. Pastaj u largua pa thënë asnjë fjalë. U dëgjua urdhri i dikujt që ta çonin kufomën në morg, por më të shpejtë nga sanitaret që u sorollatën për të gjetur një bartëse, u treguan gazetarët, të cilët arritën të gjenin kufomën aty ku kishte rënë, ta filmonin me kamerat e tyre të zeza, që dukeshin si korba të zbritur nga një botë jashtëtokësore, madje edhe të fillonin pyetjet për ata që silleshin rreth të vdekurit. Njëri prej kameramanëve, pa i marrë dorën askujt, e zbuloi kufomën dhe nisi të filmojë; pas tij u turrën edhe ndonja gjysmë duzine kameramanësh të tjerë, duke shtyrë shoku-shokun e duke përplasur aparatet e tyre të filmimit.

“Orlët e mutit!”, tha dikush dhe u largua pasi hodhi një vështtrim mbushur me pezëm dhe neveri. Ndërkohë, katër sanitare e vunë të vdekurin në bartëse dhe pastaj e futën në spital. Gazetarët u turrën drejt portës, por një grua, që u ndodh te dera, ua mbylli para turinjve. Thithat e derës zhurmuuan si në një vajtim të zvargur.

Gjithë spitali, të sëmurët dhe mjekët e tyre, u trandën. Zymtimi varej në qiellzanën e çdo dhome, ndërsa nëpër mesoret e pavijoneve, mbi pllakat e fundshtrojës, kërcisnin nxitueshëm këpucë çdo lloji. Në ajër përsillej vetëm një pyetje: “Kush ishte? Ç’pati?”. Por në ato grima kohe askush nuk përgjigjej... as shiu që sapo kishte nisur të imtonte, pa mundur të fshinte gjurmët e gjakut.

Doktoreshë Borjana Damati hyri e përhumur në sallën e mbledhjeve dhe fjalët e drejtorit të spitalit i kërcitën në tru si një breshëri arme, të cilën nuk po e kuptonte se nga vinte.

Pas një imte hutimi kuptoi se ato shkrepnin përmes dhëmbëve të bukur të drejtorit:

- Ku e ke bluzën ti?

- Çfarë? - pyeti ajo pa kuptuar mirë as pyetjen e tjetrit dhe as përgjigjen e vet.

- Je nisur për dasmë? Një pacient yti u hodh nga ballkoni dhe ti më sillesh si në mbrëmje studentësh. Ku e ke bluzën? - pyeti me një zë që dilte nga zgavrat e zemërimit.

- Në morg, - u përgjigj ajo duke u kthyer përmes vdekjes, në botën reale. Por përgjigjja e saj ia përpushi



gacat drejtorit, i cili, në të bërtiturat e tij përmendi vdekjen, vetëvrasjen, gazetat dhe televizionet, ministrin, kryeministrin, të gjithë ata që prisnin përgjigje për ngjarjen e asaj pasditeje.

- Pse ndodhi?! Pa ma thuaj ti përgjigjen. Apo e ke lënë edhe mendjen në morg? Dukej aq i inatosur, sa nuk e nxinte as lëkura e vet.

Një nga shefat e pavijoneve i foli drejtorit pranë veshit, me sa duket i tregoi se doktoreshë Borjana kishte mbuluar të vdekurin me bluzën e vet dhe prandaj përgjigjja e saj nuk mbështillte ndonjë faj, aq më pak ndonjë tallje me drejtorin, siç e kuptoi ai në fillim, por ishte pjesë e atij realiteti të trishtë të asaj dite. Si për të vërtetuar atë pëshpërimë, në sallë hyri njëra nga sanitaret, me bluzën në dorë.

- Doktoreshë Bora, - iu drejtua Borjanës, - keni harruar bluzën në morg. - Ajo e mori bluzën, por nuk e veshi. Gjithçka që u fol në atë mbledhje urgjente, ishte një turbullirë e trazuar për vramendjet e doktoreshës, aq sa ajo mori vesh vetëm një gjë: i kërkohej të bënte urgjent një raport mbi ngjarjen, raport të cilin do t'ia dërgonin ministrit, kryeministrit apo dreqit vetë. Gjithë jetën ishte përpjekur të zbatonte këshillën e lashtë latine *rumores fuge*, por tani po kuptonte se jo vetëm që nuk i *largohej zhurmës*, por kishte rënë në gropën më ulëritëse të saj.

- Ishte pacienti yt, zonja Damati, është përgjegjësia jote, edhe raportin ti do ta shkruash. Urgjent! Ur... gjent... gjent... gjent! - Ishte kapur pas asaj fjale, si i

dehuri për huri. Asaj i tingëlloi si goditja e një kapaku pusete që mbyllej, ndërkohë që e ndjeu veten të taposur nën atë peshë të rëndë prej hekuri, bërtimash dhe duhmës së rëndë të nëndheut.

\*\*\*

Ndërsa doktoreshë Borjana Damati përpëlitej nëpër frazat e raportit që i jepte ndjesinë e një nekrologjie, në mesoret e spitalit kundërviral, e më së shumti në dhomat e mjekëve, u përsërit për të disatën herë ajo frazë e athtë, autorin e parë të së cilës nuk e kujtonte askush. Ata që e thoshin; ca me mllef e inat, ca me xhelozë e smirë, të tjerë pa e kuptuar as vetë pse u lëvrinte ajo frazë në gërbellat e shpirtit, ndërsa ndiheshin të kënaqur dhe ironikë duke u mëshuar atyre fjalëve, ulnin kokën kur në korridore hasnin doktoreshë Borën. “U thye, më në fund, edhe qypi i doktoreshë Grenzës! U thye... copa u bëftë!”

Nga të gjithë, të paktë ishin ata që e dinin saktësisht përse mjeken Borjana Damati e quanin “doktoreshë Grenza”. Disa mendonin se ajo nofkë i kishte mbetur ngaqë drejtori i spitalit, një tatalosh si të kishte dalë nga ndonjë novelë e Migjenit, pyeste shpesh të tjerët: “Hë, ka shkruar gjë sot ajo Grenza, ka dhënë ndonjë intervistë?”. Dhe e bënte këtë pyetje çdo ditë e më shpesh, qysh se në spital erdhi një ekip kontrolli nga ministria e Shëndetësisë dhe doktoresha e zemëruar u tall me ata që kontrollonin zbatimin e orarit të mjekëve

dhe as donin t'ia dinin se pavijonet nuk kishin ngrohje, se muret e sallës së operacionit kishin zënë myk, se kompania që furnizonte spitalin me ushqime u jepte të sëmurëve pula të krimbura e patate të kalbura. Të gjitha këto shqetësime të mjekes drejtori i merrte pluhur mbi vete dhe dëgjonte kambanat e alarmit që binin rreth zyrës së tij të ngrohtë. Edhe më shumë akoma, kur telefoni edhe kryeministri që, pa pyetur për ngrohjen, ushqimin e të sëmurëve apo muret e sallës së operacionit, i kërkoi llogari drejtorit për doktoreshën: “Ç’ e keni atë Grenzë që do të na pickojë tani në prag fushate?! Mbylljani gojën!”. “Po, po, Grenzë e vërtetë është”, tha drejtori, pa ditur të thotë ndonjë gjë tjetër më *calmante*; fjalë që e përdorte që pas një specializimi dyjavor në Itali.

Drejtori nuk guxoi atëherë ta thërriste në zyrë Borjana Damatin, sepse, qeni qepën ta hajë, të gjitha kritikantat (*ah, më mirë të themi vërejtjet*) ishin të vërteta. Ishte vetë kryeministri që sulmoi doktoreshën, natyrisht pa ia përmendur emrin. Në faqen e vet sociale vuri ca fotografi të bukura nga spitalet dhe, nën to, atë proverbin e famshëm shqiptaro-ballkanik: *Qentë le të lehin, karvani të shkojë përpara*. Drejtori u gëzua, ngaqë kuptoi se faji i tij për problemet e spitalit që kishin dalë nëpër gazeta dhe portale, kishte rrëshqitur tashmë si kallaji mbi gunën e kryeministrit. Por dy orë më vonë, iu liruan burmat e trurit, kur njëri nga mjekët që e informonte për çdo gjë që ndodhte në stanin e tij, me fytyrë të murrëtyer

si pleh i pakalbur, i tregoi një faqe portali ku ishte publikuar përgjigjja e Bora Damatit ndaj proverbit të kryeministrit të vendit: *(Kar)vani leh, qentë shkojnë përpara!* Drejtorit nuk i ra qiellzana mbi kokë, siç thuhet, por iu shemb nënshtrija poshtë këmbëve. “Do ta shtyp! Do ta shtyp!”, thërriste dhe dukej se të gjitha fjalët e tjera të shqipes i kishte harruar. “Grenza e mutit!” Por fytyrëplehu e këshilloi: “Mos e nga grenzën me krane, se e nget të zezën tande”, duke nënkuptuar kështu mënyra të tjera për të shpëtuar nga pickimi i insektit mistrec. I kujtoi edhe atë mënyrën se si vreshtarët mbronin rrushin e tyre nga grerëzat, me dy shishe *kokakola* të prera në mes dhe pastaj të bashkuara, duke futur grykën e njërës te pjesa e gjerë e tjetrës. Grerëzat, të tërhequra nga aroma e pijes së ëmbël, hyjnë nëpër grykën e hapur të njërës për të thithur lëngun në fundin e tjetrës dhe...

“Dhe...?” - pyeti drejtori.

“Dhe nuk dalin dot më, sepse nuk e gjejnë grykën e shishes për të dalë.”

“Kjo Grenza jonë del edhe nga vrima e gjilpërës”, tha drejtori.

Por ato ditë, pas vetëvrasjes së pacientit, edhe ai u bashkua me ato zëra që pëshpëritnin: “U thye, më në fund, edhe qypi i doktoreshë Grenzës”. Asnjërit prej tyre nuk i kujtohej, nuk i shkonte në mend dhe as kishte dëgjuar që atë emër, Borjana Damati ia kishte vënë vetes. Kur përgatiti temën e diplomës në universitet, temë që u vlerësua me notën më të lartë, krahas

kushtimit që ua kishte bërë prindërve dhe familjes, “Pa të cilët do të isha askush dhe nuk do të arrija askund”, kishte shtuar edhe një “kuriozitet filozofik”: *Grerëza ka një sipërfaqe fluturuese 0.7 cm. katror dhe peshë 1.2 gram. Sipas ligjeve të aerodinamikës është e pamundur që, me këto përmasa, të fluturojë. Grerëza nuk e di këtë dhe vazhdon të fluturojë.*

Njëmbëdhjetë ditë pas vetëvrasjes së parë, ndodhi e dyta. Nga i njëjti ballkon i spitalit, thuajse në të njëjtën orë. Ngjarja e dytë tragjike u bë lajm i të gjitha mediave dhe rrjeteve sociale; për të flitej nëpër zyra, rrugë dhe kafene. Borjana Damati e ndjeu veten në kurthin e vdekjes dhe të vetmisë së idhtë. Ditën e kalonte disi, e dhënë pas punës dhe të sëmureve të tjerë, por natën nuk e duronte dot heshtjen makabre të yjeve dhe i dukej se, nga çasti në çast, do të çahet cipa e qiellit e ato do të binin në tokë, do të përplaseshin nëpër gurë e shkrepë, në rrugë e puseta kalbësirash.

Për më tepër që i vetëvrari i dytë i qe dukur një burrë i qetë, serioz dhe dashamirës. “Mos u shqetëso doktoreshë, ti nuk ke asnjë faj”, i pat thënë kur plasi zhurma për vetëvrasjen e parë. Ajo nuk iu përgjigj, por atë thënie e mendoi shumë gjatë. Çfarë di ky për tjetrin; ndoshta ka dëgjuar ndonjë gjë, ndonjë bisedë, ndonjë ankesë, ndonjë varje ndërgjegjeje. E dinte se të jetuarit me ndjenjën e fajit ishte diçka e tmerrshme, të cilën po e ndiente tashmë edhe në lëkurë të vet. “E kaluara peshon më rëndë se një pllakë varri”, kujtoi

diçka nga leximet e hershme, u përpoq të gjente emrin e filozofit që i kishte thënë ato fjalë, por errësira e kujtesës nuk po i zbulonte asgjë. Më shumë për të qetësuar veten sesa e sigurt, mendoi që ato ishin fjalë të Dekartit, apo ndoshta edhe të Borhesit. “E kaluara vret më shumë se pushka”, përsëriti fjalën shqiptare, në analogji me sentencën filozofike. E kaluara kalb gurin, tret edhe burrin... E kaluara shpellon në çdo shpirt njeriu... U përpoq të dilte nga ai labirint dhe u nis drejt dhomës, ku kishin qenë të shtruar dy të vetëvrrarët, por, sapo e hapi derën, ndërroi mendje. Të sëmurët e tjerë të asaj dhome iu dukën si të huaj, të zbritur nga një botë e çuditshme, që me vështrimin e tyre sikur e pyesnin: “Ku jemi këtu? Në ç’planet kemi rënë?”. Gërbellat e tyre psikologjike po ktheheshin në stërmundim për mjeken. Kishte frikë t’i shikonte në sy, sepse i përbirohej nëpër tru ajo pyetja e famshme që Frojdi kishte bërë për Niçen: *Sa vetëvrasës është ky pacient?*

E tërhoqi derën e dhomës pa u thënë dot asnjë fjalë të sëmurëve dhe u kthye në zyrën e saj. Nuk i mbajti dot lotët dhe ca pika ranë mbi tavolinën e punës. Vuri re që ata lot ranë mbi një copë letër që nuk ishte e saja, dikush e kishte sjellë në kohën që s’ishite aty. E mori në dorë dhe e lexoi. “Me rekomandimin e kryeministrit shkarkoheni nga detyra e shefes së pavijonit numër katër të *Covid-1984*. Mbani përgjegjësi derisa të emërohet shefi i ri.” U habit me ndjenjën e indiferencës që e kaploi në atë imtë. Në

rrethana të tjera, me siguri do të ishte tronditur shumë nga ai shkarkim i beftë, por atë ditë jo; nuk kishte kohë as nge të mendonte për fatin e vet, ndërkohë që nga pavijoni që drejtonte ishin nisur dy arkemorte drejt varrezave të qytetit, ndërsa emri i saj lakohej në çdo gazetë dhe portal, sikur atë sëmundje të tmerrshme që po trondiste gjithë botën, ta kishte shpikur ajo, diku, në ndonjë laborator të errët.

“Po ai burracaku?”, mendoi për drejtorin. “Nuk pati kurajën të ma thoshte vetë, por ma njoftoi me këtë letër paçavure!” Megjithatë nuk e vrau mendjen shumë as për sjelljen e tij. Madje, ndiente njëfarë çlirimi, sikur i qenë lehtësuar supet nga emri i rëndë “shefe” dhe mund të lëvizte më lirshëm në ujërat e jetës së vet. “Ndoshta mund t’u përkushtohem më tepër shkaqeve të kësaj që po ndodh”, mendoi. Kishte lexuar në lajme të ndryshme që edhe në disa vende të tjera ndodhnin vetëvrasje të të sëmurëve nga ai *Covid-1984* i tmerrshëm, të cilin mjekët dhe politikanët e quanin “armik të padukshëm”. Presidenti i sapozgjedhur i Amerikës kishte kumtuar që nga ajo sëmundje kishin humbur jetën më shumë amerikanë sesa nga dy luftërat botërore dhe ajo e Vietnamit, të marra së bashku. Midis atyre mijëra të vdekurve, të cilët në gjithë botën kishin kaluar shifrën e disa milionëve, me siguri ka edhe të vetëvrasë të tjerë. “Nuk janë vetëm këta dy tanët”, mendoi. E tronditi rikujtesa e një lajmi nga vendi fqinj, ku thuhej se ishin vetëvrasë edhe dy mjekë. Për njërin prej tyre thuhej se



ishite hedhur nga kati i shtatë i spitalit, sapo i kishte vdekur një i sëmurë. “Kushedi pse është ndier fajtor”, mendoi Bora. “Po unë?” Ndjeu një shqetësim që sapo kishte filluar të shpellonte brenda saj. Megjithatë, brenda vetes, ndjeu nevojën për të qenë më e butë, më mirëkuptuese me ndërgjegjen e vet, a ndoshta edhe me rrjedhat e nënvetëdijes. Mbase për këtë arsye kujtoi priftin, për të cilin kishin folur shumë televizione, për shënjimimin e tij njerëzor duke hequr dorë nga respiratori i vet, për t’ia dhënë atë një djali të ri të saposhtuar në spital. “Ka ende njerëz kjo botë”, mendoi Borjana, “përndryshe ç’do të duheshim ne mjekët?”

Doli nga zyra, duke e lënë derën hapur për shefin apo shefen e re që do të vinte në vend të saj. Kolegë dhe të sëmurë, me të cilët u këmbye në korridor, e shikonin krejt ndryshe nga ditët e tjera. “Apo më duket mua ashtu; me siguri, sepse këta nuk mund ta dinë që unë sapo jam shkarkuar, të paktën të sëmurët, jo.” Por kur kaloi pranë një salloni, që shërbente për pritjen dhe takimin e familjarëve, sytë i shkuan tek ekrani i një monitori dhe diçka, si një rrymë elektrike, e përshkoi në gjak dhe nerva, kur lexoi emrin e vet. “Shkarkohet shefja e pavijonit numër katër të *Covid-1984* për shkak të dy vetëvrasjeve.” Ajo frazë u zëvendësua nga një tjetër: “Kryeministri urdhëroi...”, por nuk u ndal ta lexonte të plotë atë njoftim, vazhdimin e të cilit e hamendësoi. Ndjesia e

rrymës elektrike nuk po i largohet nga trupi. “Jam bërë si bretkosë eksperimenti”, përsiati në një vramendje të pakuptueshme dhe iu kujtuan punët laboratorike në universitet, kur eksperimentonin sjelljen e bretkosave ndaj rrymës elektrike. “Bretkosë eksperimenti! Vallë kështu jam bërë?” Në telefonin lëvizës u lajmëruan dy thirrje të njëpasnjëshme, të dyja të panjohura. Hapi të parën dhe dëgjoi zërin e një gazetareje të kronikës së zezë, ia mbylli dhe vendosi të mos i përgjigjej askujt, të paktën atë ditë.

Hyri në dhomën e të sëmurëve; iu dukën sikur i kishte zënë agjrami<sup>1</sup> që u brente trutë e kokës dhe sytë e ballit. Shikoi të gjithë matjet e temperaturës, oksigjenit, tensionit dhe i vështroi sikur do t’i pyeste: “Po tani kush e ka radhën?”. Çuditërisht, edhe vështrimi i të sëmurëve dukej i mjegulluar nga e njëjta pyetje: “Na thuaj ti, doktoreshë, kush nga ne e ka radhën?”. E njëjta pyetje, por... Ajo e saja kishte fluturuar si një shigjetë e lëshuar në pyll, pa drejtim, pa zhurmë, pa e parë askush se ku do të binte. Ndërsa pyetja e të sëmurëve ishte shigjetë që godiste vetëm në një pikë, në gjoksin e saj, në zemrën e saj. Ajo, dhe jo ata, duhet të përgjigjej.

“Na erdhi keq, doktoreshë Bora...”, foli njëri prej tyre.

“Por ti nuk ke asnjë faj”, e plotësoi tjetri, pak më i ri se i pari. Fraza e dytë iu ngul në tif të kokës. Po kjo?

---

<sup>1</sup> Sëmundje brejtëse e pemëve. (Shën. i autorit.)

Janë të njëjtat fjalë, siç m’i tha ai që u vetëvra sot. Të jetë rastësi apo ka diçka. Po kush e ka fajin, deshi të pyeste, por ato fjalë u shkërmoqën pa arritur në pejzat e gjuhës së saj.

Telefoni ra përsëri dhe ajo vuri re që ishte thirrësi i parë që këmbëngulte. Kur bëri thirrjen e tretë ajo e hapi e përgatitur ta sikteriste në esfel, cilido gazetar apo gazetarë të ishte, çfarëdo zyrtari ministrie apo edhe çfarëdo prokurori, por e mbajti gjuhën, kur dëgjoi një zë të njohur, të cilin prej shumë kohësh nuk e kishte dëgjuar.

- Bora je?

- Ooo, profesor Reka, qenkeni ju?

- Po, unë jam... kur të kesh kohë, eja për një kafe. Të bisedojmë.

- Patjetër, profesor, - tha ajo dhe ndjeu njëfarë çlirimi.

\*\*\*

Profesori e priti në një internet-kafë poshtë pallatit ku banonte. Ishte plakur shumë. Sytë i lagështonin, trupi i qe rrudhur si bishti i qershisë, mbante bastun, por ajo do ta njihte edhe po ta shikonte në një turmë të madhe njerëzish apo pleqsh. E kishte dashur shumë atë profesor, që ditën e parë kur erdhi në auditor dhe, kur dëgjoi emrin e saj, e pyeti se kush ia kishte vënë emrin Borjana. “Gjyshi”, i tha ajo. “E paska dashur shumë fshatin e vet”, tha profesori, dhe më vonë i

tregoi se dikur kishte qenë në atë fshat, dhe ndoshta e kishte njohur apo takuar edhe gjyshin e saj, që emrin e fshatit të vet ia kishte vënë asaj, duke e feminizuar me një prapashtesë. Por, i pëlqente më shumë kur e thërrisnin shkurt, Bora. Më vonë e mori vesh se profesori qe internuar për nëntë apo dhjetë vjet, vetëm pse në atë fshat kishte zbuluar një sëmundje, të cilën të tjerët, ata të shtetit, nuk donin ta pranonin. Ah, po kjo sëmundje e tanishme nga na erdhi?

Profesori kurrë nuk u foli për atë sëmundje që e çoi në baltërat, përcëllimat dhe cegmat e internimit, por ndoshta si jehonë të asaj ngjarjeje u përsëriste shpesh gjatë leksionit:

“Sëmundjen duhet ta kërkonin aty ku të tjerët nuk e shohin”.

Edhe atë ditë, kur kishin kaluar njëzet vjet nga koha që ligjëronte për studentët të rejat dhe zbulimet më të fundit të mikrobiologëve të botës, e përsëriti atë shprehje, dhe Bora Damati qëndroi një grimë e menduar e pa folur. E vështroi profesorin në sy dhe dallooi se nën hirin e tyre regëtinte prushi i fundmë i jetës. Por në mendje ishte i kthjelltë, pa brymë në tru.

- Shiko çfarë shkruajnë, - i tha ai dhe i zgjati një fletë të sapoprintuar nga interneti i kafenesë. “Në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara, sondazhet e kryera që nga fillimi i pandemisë *Covid-1984* sugjerojnë se teoritë konsiprative kanë pasur njohje dhe përhapje të gjerë. Si tendencë e përgjithshme, rreth një e katërta e popullsisë duket se besojnë në to. Nga gjashtë

teoritë më të zakonshme konspirative të zbuluara në nivel botëror, tri kanë më shumë besimtarë sesa jobesimtarë. Tri teoritë më të çuditshme janë ato që e lidhin *Covid-1984* me krijimin e virusit në një laborator kinez; me teknologjinë 5G dhe synimet për të kontrolluar çdo qelizë të jetës njerëzore, dhe e treta, ajo e përfshirjes së ushtrive të fuqishme për krijimin e virusit si armë biologjike. Të dhënat për Poloninë tregojnë se 23 për qind e popullsisë i beson këto teori, madje 23.5 për qind janë të mendimit se kjo pandemi është pjesë e një komploti ndërkombëtar. Në Itali besojnë në këto teori 25 për qind e të anketuarve. Edhe rezultatet e një sondazhi në Gjermani dalin me shifra të ngjashme, ndërkohë që 8 për qind mendojnë se janë disa organizata sekrete që ndikojnë në vendimet që merren për pandeminë. Shumica e këtyre besojnë se media dhe politika, të vëna nën thundrat e fitimeve të kompanive mafioze farmaceutike, po i fshehin të vërtetat e kësaj kolere të shekullit 21.”

Bora nuk vazhdoi më tej dhe ia ktheu letrën profesorit.

- Mora vesh që të shkarkuan nga pavijoni, - i tha profesori.

- Po, nuk po e vras mendjen për këtë.

- Kërkoje atje ku nuk duket, - përsëriti profesori, por në zërin e tij tashmë lëvrinte një enigmë e pakuptuar nga Bora Damati. - Përpiqu të shpëtosh nga ndjenja e fajit, jeta bëhet skëterrë prej saj. Të shpëtosh veten dhe të tjerët.

Bora ndjeu ngrohtësinë e prushtë në sytë e profesorit, e përqafoi dhe u largua. Ai e ndoqi për një copë herë me sy të përлотur prej pleqërisë dhe trishtimit.

“Shumë pak e dinë se sa peshon një i vdekur”, mendoi dhe u ndie i lodhur nga grindjet e tij të stërzgjatura me vuajtjen e të tjerëve. Ndërkohë, ish-studentja e tij përsëriste në mendje këshillën e tij të fundit: “Shpëto veten dhe të tjerët... nga ndjenja e fajit, nga kalbja para se të vdesin, nga skëterra e jetës”.

Kurrë nuk i kishte shkuar në mendje se do të takonte bashkëshorten e të vetëvrrarit të dytë, Fitim Zagorës. Një mëngjes ajo i doli përpara, në hyrje të spitalit. Për një grimë nuk e njohu, por në çast u kujtua, e kishte takuar dy apo tri herë për t'i treguar gjendjen shëndetësore të të shoqit. Madje i kishte dhënë shumë shpresë e besim, “do ta kapërcejë”, i kishte thënë në çdo takim me të. Kur krejt papritur... “Pse më gënjeve, doktoreshë?” E priste këtë pyetje, por tjetra nuk e bëri. Borjana Damati hodhi një sy aty rrotull, duke menduar se mos ajo grua e veshur me të zeza do të kishte ardhur e shoqëruar me ndonjë nga ata “të fortët”, si quheshin ato kohë, për të kërkuar “hesap” apo edhe për ta kërcënuar. Muajt e fundit ishin shtuar kërcënimet ndaj mjekëve, dy-tre edhe ishin rrahur, njërin madje e kishin plagosur me thikë. Se ku kishin kapur një infermiere që kishte grabitur dita më ditë dy-tre pacientë dhe të gjithë ishin turrur kundër mjekëve, gazetata, televizionet, *porthalet*, siç i quajti një koleg i Borës, deputetë e prokurorë, të fortët dhe të dobëtit, emisionet e mëngjesit dhe ato të mbrëmjes. Politika ishte treguar më dinake, duke

hedhur gurët e duke fshehur duart, për të zbrazur të gjitha mllefet e pakënaqësisë së njerëzve diku tjetër dhe jo në oborrin e saj. Prokurorët nxitonin të hapnin dosjet për mjekët në të ashtuquajturën luftë kundër korrupsionit, duke menduar se, me gjasë, njerëzia do të harronin bëmat e tyre dhe të gjyqtarëve që nxirrnin nga burgjet edhe vrasës që paguanin në një dorë aq sa një mjek nuk i fitonte as për pesë vjet. *Gjylja ra në kazanin e tyre*. “Po, po, në kazanin tonë”, mendoi Bora. Dëshpërimi i familjarëve për njerëzit e tyre të vdekur apo të vetëvrarë, i nxitur edhe nga urrejtja që mbillte politika dhe të gjithë shegertët e saj, po e kthenin atë kohë pandemie në një lojë të ndyrë dhe djallëzore.

- Jeni vetëm? - pyeti, pas një grime të ngarkuar me elektricitetin e shpërthimit ndaj gjithë asaj skote të turrur kundër mjekëve, ndërkohë që ato ditë emri i saj gjendej brenda syrit të ciklonit. “Dhe dreqi e din se kur do të dal prej andej”, mendoi.

Por zëri i trishtuar i gruas, duke ia hedhur edhe vetë Borës atë vel zie, sikur e qetësoi:

- Vetëm kam mbetur, fëmijët jashtë, burri...

Bora i futi krahun dhe hynë brenda. Kur u ulën, priti që gruaja e të vetëvrrarit të fliste, por si duket ajo kishte harruar fjalët që donte të thoshte. “Ndodh shpesh kështu nga trishtimi”, mendoi doktoresha.

As ajo nuk foli, por i kapi dorën gruas për ta qetësuar apo për ta nxitur të zbrazte gjithë atë helm që i kishte nxirë trup e shpirt.



- Jo, asgjë, - foli gruaja, - erdha thjesht të të falënderoja për kujdesin që tregove...

- Por ai...

- E di, ai nuk është më, por ti u kujdese si motër, edhe më shumë se një motër. Më kanë thënë që po të bien në qafë, se edhe prokuroria... unë dua t'u them të gjithëve të vërtetën... ti s'ke asnjë faj.

Borjana u ngrit ta përqafojë dhe në kraharorin e saj ndjeu dridhmat e njohura të gruas që ka humbur bashkudhëtarin e papërsëritshëm të jetës së vet. Pastaj e pyeti:

- Kishe menduar ndonjëherë... apo kishe dëgjuar ndonjë fjalë, apo parë ndonjë shenjë që të... të mendonte për këtë që bëri?

Gruaja ngurroi të përgjigjej. Dhe qëndruan ashtu, ajo kokulur dhe Bora syngulur mbi fytyrën e saj, të zverdhur e nervoze. Pastaj rregulloi një cullufe flokësh që i kishte rrëshqitur mbi ballë, e ngriti paksa kokën dhe tha atë që doktoresha nuk e priste, edhe pse në pyetjen e saj kishte shpresë dhe kërsëri.

- Po, ka ndodhur një herë, shumë vite më parë... unë... mendova se ai e kishte kapërcyer, por ja që koha më gënjeu.

- Ndoshta *covidi* ia rizgjoj fantazmat, - tha Bora, e menduar.

Gruaja rrotulloi dy-tri herë rreth gishtit unazën e martesës dhe Borës i shkoi nëpër mend ndonjë krizë martese, ndonjë tradhti bashkëshortore, e asaj apo e atij, apo ndoshta e të dyve bashkë, ndryshe pse do ta

prekte atë unazë. Ajo besonte shumë në marrëdhëniet e njeriut me objektet që bart në trupin e vet, si një tregues jo vetëm të psikikës, por edhe si një katalizator kujtimesh, të cilat gjithkush do të kishte dashur t'i harronte. “Kujtimet dhembin”, mendoj Borjana. Në raste të tilla edhe një unazë martese mund të bëhet timon i makinës që të shpie në thellësitë e të shkuarës, në atë që psikologët e quajnë *vetëzhbirim*, ku mund të gjeje pendesë dhe turp, frikë dhe pasiguri e deri edhe flirtin me vetëvrasjen. Bora nuk foli dhe kështu e nxiti tjetrën të shfletonte paksa nga jeta e vet.

\*\*\*

Burri i saj për shumë vite kishte punuar veteriner në një kooperativë malore. Atje dhe ishin njohur, kur ajo shkoi si mësuese vullnetare. (“Vullnetare me policë nga mbrapa”, tha ajo.) Krejt papritur, atë e thirrën në komitet dhe i thanë që do t'i linte bagëtitë e kooperativës dhe do të zbriste në qytet.

- Veteriner në qytet? - pyeti ai, - do të mbarështoj qentë endacakë?

- Jo, do të bëhesh ti vetë endacak.

E mori në thua atë fjalë të njeriut të komitetit dhe deshi t'ia kthente mbrapsht patkoin, por tjetri u tregua më i shpejtë dhe e qetësoi:

- Do të bëhesh gazetar, - i tha, - po hapim gazetën lokale dhe kemi menduar edhe për ty. Ai nuk e mendoj gjatë dhe pranoi. “Boll janë dhjetë vjetët që kalova në

mes bajgave dhe kashtës së kalbur”, mendoi atë imtë. Diku-diku, thellë vetes, i kishte pasur zili gazetarët. Bridhnin ku të mundnin, qoftë edhe ku i urdhëronin, dhe mbushnin ato katër faqe gazetë, pa i dhënë llogari askujt nëse u realizua plani i qumështit, mishit apo leshit, pa i shkuar prokurori në mesnatë për ta pyetur pse kishin ngordhur viçat apo qengjat e kooperativës, pa i tringëlluar prangat kur kalbej misri, siç kishin bërë me kryeagronomin e fermës më të madhe të rrethit. Njëherë, madje, kishte dëgjuar nga një gazetar që e njohu rastësisht në restorantin e qytetit, se Balzaku a Hygoi, i ngatërronte këta dy emra, paska thënë që profesioni më i mirë është ai i gazetarit.

- Edhe unë ashtu mendoj, - i tha ai. - Por me një kusht, - vazhdoi tjetri, - që ta lësh në kohën e duhur.

“Ta filloj njëherë, pa kemi kohë për ta lënë”, mendoi, kur njeriu i komitetit i bëri atë propozim. Dhe kështu Fitim Zagora filloi punën e gazetarit, pa qenë i tillë. Kur doli nga komiteti, mezi priste sa t’ia njoftonte atë lajm gruas së vet, në fshat. U nis për në postë ta lajmëronte në telefon, por ndërroi mendje. “Më mirë t’ia them në sy dhe të shikoj sa do të kënaqet. Pastaj...” Dhe kujtoi talljen me sekretarin e parë të rrethit, e cila lëvrinte nëpër të gjitha skutat e qytetit dhe barnishtet e fshatrave. E kishin thirrur në Tiranë dhe i kishin komunikuar që do të zëvendësonte shokun Qako në detyrën e sekretarit të parë. Sapo doli nga zyra e kuadrit shkoi në zyrën e një shoku dhe i telefonoi gruas.

- Merushe moj, - i tha, - a din se me kë ke me fjetë sonte?

- Me kë?

- Me sekretarin e parë të rrethit.

- A me shokun Qako? - pyeti ajo.

Kështu që Fitim Zagora e ruajti veten nga ndonjë përrallje katundi; kishte plot njerëz që boll të kapnin një grremç dhe pastaj varnin e zhvarnin gjithfarë fjalënajash që u pillte mendja.

Shumë shpejt erdhën me banim në qytet, ajo u rregullua në një shkollë tetëvjeçare, morën edhe shtëpi pa shumë vuajtje, fëmijët po rriteshin ashtu si edhe fama e tij por... jo si gazetar. Kolegët që vinin nga kryeqyteti e kërkonin gjithnjë dhe ai i shoqëronte atje ku ata gjenin gjëra interesante për shkrimet, por edhe gjëra të tjera që mungonin në kryeqytet; herë dy arka me mollë, herë një thes me fasule, herë një shpatull a kofshë viçi nga ato të therjeve të sforcuara. Dhe e rregullonte gjithmonë që t'i merrnin pa lekë, ose me çmim të ulur. Disa herë, kur merrej vesh me llogaritarët, u thoshte kolegëve: “Kësaj radhe e ke nga unë, mos ma prish!”. E kush t’ia prishte?! Përkundrazi, ia ndreqnin. Filluan t’i botonin shkrime edhe në gazetatat qendrore dhe emri i tij u bë i njohur për shumëkënd. Por krenaria gazetareske nuk i zgjati shumë. Pa kaluar as një vit, e morën instruktor në komitetin e rrethit, “në sektorin më të rëndësishëm” siç i tha shefi, në atë të edukimit revolucionar të masave punonjëse. U habit edhe me veten kur ndjeu

mall për gazetën, por nuk u kthye kurrë më në ato zyra e në atë punë. Ndërkohë s'mund të mos e vinte re se edhe gazetarët, me të cilët kishte ndarë lodhjet dhe mundimet nëpër fshatra, apo kishte ndarë bukën e mëngjesit, kur mblihdeshin rreth sobës për ta thekur, edhe ata pra, filluan ta quanin "shef". - Çfarë shefi? - u tha ditët e para, por pa kuptuar, në ditët që erdhën më pas, i pëlqente ai emërtim, sidomos kur telefononin në shtëpi dhe pyesnin gruan: "në shtëpi është shefi?".

"Nuk më shkuan dëm ato vite bajgash!", i thoshte shpesh vetes dhe gruas.

Krejt papritur, i telefoni një zë i panjohur.

"Nesër në orën 9:00 të paraqiteni në Komitetin Qendror." Shtëpia i erdhi rrotull dhe gruaja i dukej si një flutur e verbër që vërtitej rreth llambës së sallonit. Çfarë të jetë kjo? Nuk tha as emër dhe as detyrën që kryente. Nuk tha as edhe ku, në ç'zyrë, me cilin shok do të takohej. Mos po tallet ndonjë nga kolegët? Kishte plot nga ata që nuk ta përtonin. Të gjithë bashkë ia kishin punuar një kolegu të tyre, të sapokthyer nga një vizitë jashtë vendit. Ishte ditëlindja e tij dhe ata i shkruan një letër urimi që vinte gjasme nga ambasada. "Bah, shih sa të kujdesshëm janë! Jo vetëm që e dinë ditëlindjen time, por edhe më dërgojnë urim!"

Por jo, ajo telefonatë s'mund të ishte shaka, as tallje. Për shumëçka bënë humor, për ministra e parulla të ditës, por kurrë nuk guxonin dhe as do të guxonin të talleshin me emrin e Komitetit Qendror. "Të gjithëve na shpëton shurra nga ai emër". E dinte se asnjë nga

gazetarët nuk dilte për kafe para orës njëmbëdhjetë në ditën kur kishte botuar ndonjë shkrim të rëndësishëm. Priste ndonjë telefonatë dhe ato zakonisht bëheshin para orës njëmbëdhjetë. Shumë nga ata ishin përzënë nga puna, ishin dërguar në ndonjë fermë a minierë, pikërisht pas atyre telefonatave. Ora njëmbëdhjetë ishte bërë për ata si lëkura e ujkut që tremb kecin. Frika nga ai emër ishte edhe më drithëruese nëpër skutat e komiteteve, aty ku askush nuk guxonte të kuptonte ato që shihte. E kjo dridhërimë bëhej edhe më e madhe në kohëra konferencash, plenumesh dhe kongresesh. “Ah, këto të uruarat kongrese, sa fat më kanë sjellë!”, mendonte shpesh Fitim Zagora. Frika dhe fati, çfarë bashkëjetese e çuditshme dhe dramatike në jetën e tij. I kishte dalë nami si shkruer i diskutimeve të mira, madje shumë të mira për të gjitha llojet e kongreseve, të partisë, të rinisë, të bashkimeve profesionale, të grave, madje edhe të kooperativave bujqësore, edhe pse ato bëheshin rrallë e më rrallë. Kishte shkruar diskutime për metalurgë e mjelëse, për veteranë e valltarë, për burra dhe vajza. Diskutimi i fundit, para se ta thërrisnin në Komitetin Qendror, ishte për një delegate të një fshati kufitar. Pasi e shkroi, qëndroi tri ditë për ta mësuar atë vajzë si ta lexonte diskutimin, kur ta ngrinte dhe kur ta ulte zërin, ku t’i mbante duart dhe si t’i lëvizte ato, kur të përmendej emri i udhëheqësit apo i armiqve të shtetit. E vërteta është që ajo vajzë “e tundi” me një lexim të guximshëm e me një zë burrëror. Por në ato

grimca kohe kur Fitim Zagora priste që diskutimi i tij të lavdërohej, një instruktor i Komitetit Qendror, që njihej edhe si shkrimtar, lëshoi gjylen në këmbët e tij: “Shumë militarist ai diskutim!”, i tha. “Jetojmë në kufi”, u mbrojti Fitimi, por tjetri u largua turfullues. Në ditën e mbylljes së Kongresit pritej të vinte Enver Hoxha, por ai nuk erdhi, dërgoi një mesazh të incizuar. Dhe... Fitim Zagora u drodh sikur në trupin e tij të kishte rënë tërmet. “E dëgjuat sa bukur e tha delegatja nga kufiri: ‘Armiqtë na kanë në griqë të pushkës, ne i kemi në griqë të topit’”. Po të kishte krahë do të fluturonte. Megjithatë fluturoi edhe pa krahë, natën e asaj telefonate të papritur. Ishte telefonatë e orës 11:00, por me një ndryshim të madh kozmik, nuk ishte njëmbëdhjeta e mëngjesit, por e paramesnatës, ishte telefonatë gjumëvrasëse për shumëkënd, por jo për Zagorën.

- Pas asaj telefonate ndryshoi jeta jonë, - i tha dokoreshë Borës gruaja e Fitim Zagorës. - Ai filloi një punë të re, në Komitetin Qendror të Partisë, por mua më tregoi shumë vite më vonë se çfarë pune bënte. Ishte tepër sekret.

- Dhe kjo ka ndonjë lidhje... mendon se...

- Ndoshta... nuk jam e sigurt, nëse vdiq i lirë nga sekretet që e kishin torturuar gjithë jetën.

Nxori nga çanta një fletore të trashë shënimesh dhe ia zgjati dokoreshës.

- Po çfarë dreq pune ishte ajo? - nuk duroi dot pa pyetur Borjana Damati.

- Kur u verbua diktatori, ai shkante çdo mëngjes në shtëpi për t'i lexuar gazetat dhe lajmet. Prandaj nuk më kishte treguar asgjë, sa qe gjallë diktatori.

- Ah! Sa kohë zgjati kjo punë?

- Dy-tre vjet më duket, ndoshta edhe më pak. Në atë fletore ka shkruar disa kujtime nga ajo kohë. I ka shkruar vonë, më përpara ishte frikë t'i përmendje dhe jo më t'i shkruaje... Atë më thoshte gjithmonë, kur i shkruante këto kujtime, jetuam me frikë e tani jetojmë me turpin dhe pendimin pse patëm frikë.

- Ah! - tha përsëri Borjana, dhe për të mos u dukur tuhate përpara asaj gruaje, shtoi: - Nuk e dija këtë punë. Por... kur i ka shkruar këto; the vonë, po kur saktësisht?

- Ka zgjatur shumë kohë. Me vite, mund të them; shkruante, pastaj i fshihte diku apo edhe i griste dhe pas disa muajsh ia niste nga e para, mund të ketë vazhduar derisa e zuri *covidi*, nuk jam shumë e sigurt... Unë kurrë nuk e kam pyetur, as ai nuk më ka folur për këto. Kur u shtrua këtu, më dërgoi fjalë dhe porosi edhe për këtë fletore.

Borjana e shfletoi, pa lexuar asnjë fjalë.

- Të lutem, mos ia trego askujt, - iu lut gruaja. - Vetëm për ty e solla, ndoshta gjen ndonjë arsye pse ai vendosi të hidhej nga ballkoni. Thjesht për ta ditur, asgjë tjetër.

Bora Damati i dha një shami për të fshirë lotët. "Sa trishtim ngjall një vejushë e hidhëruar", mendoi, duke parë dridhmën e lehtë të gishtërinjve të saj. E



hidhur është çdo vdekje, por hidhërimi bëhet më i padurueshëm, kur vdekja lë pas një turp çnderimi, apo një enigmë vetëvrasjeje. Kishte lexuar një statistikë shtetërore që tregonte se numri i vetëvrasjeve atë vit, 215 gjithsej, kishte kaluar shumë numrin e vrasjeve që po atë vit kishin qenë 55. Por për vetëvrasjet nuk shkruajnë shumë; ato nuk janë kronikë e zezë, as e kuqe apo blu; janë kronika gri e kohës sonë. *Shqiptarët janë burra të pashëm, fisnikë, të guximshëm, me prirje për vetëvrasje... me mërzinë për të jetuar...*, kishte shkruar Guillaume Apollinaire në vitin 1907, citat të cilin ua kishte përsëritur shumë herë profesori i leksioneve mbi psikikën e sëmundjeve të ndryshme. Shifra alarmante vinin edhe nga vende të tjera; në SHBA ishte shtuar shumë numri i të vdekurve nga mbidoza vetëvrasëse e drogës, në një vit pandemie vdiqën 93.331 persona dhe mjekët e shpjegonin këtë me ndikimin e *covidit* mbi shëndetin mendor të njeriut.

*S* humë pak njerëz e dinin se për çfarë shërbente Sajo zyrë ku më kishin futur mua... Me këtë frazë nisnin kujtimet e Fitim Zagorës... Vetëm gruaja e tij, sekretari i propagandës dhe, ndoshta, Kryeministri. Të tjerët, që e kuptonin se unë isha thirrur aty për një punë sa të rëndësishme po aq edhe të mjegulltë, më shikonin sikur të isha Nil Armstrongu i sapozbritur nga hëna. Po e bëj sot këtë krahasim, sepse atëherë askush nuk guxonte të fliste për shkencën amerikane.

Në ditët e para as unë vetë nuk e kuptoja se çfarë do të bëja në atë zyrë, të vogël vërtetë, por të mobiluar me hijeshi. Kishte një etazher të mbushur me libra, me të gjithë librat e botuar nga “ai”, vepra të serisë, vepra me karakter tematik si ato për Gruan, për Artin dhe Kulturën, për Naftën, për Bashkimet Profesionale për... për... çfarë gjeniu, mendoja atëherë. Kohët e fundit lexoheshin sidomos kujtimet e “tij”, kujtime të vegjëlisë, ato të mëvonshmet, pastaj kujtimet e luftës, shënimet politike, për titistët, për Kinën, për vendet arabe, për hrushovianët... Kur “ajo”, gruaja e udhëheqësit, hyri në zyrën time (imja apo e saja?!) unë po lexoja pjesë nga shënimet mbi superfuqitë.

- Ah, sa mirë që po e lexon këtë vepër madhore...

Unë mbeta si guak dhe më shpëtoi nga hutimi vetëm një kopje pikturë ku paraqitej Lenini pranë një varke në brigjet e Finlandës, apo kushedi se ku tjetër.

- Është Lenini i kohës sonë, - i thashë dhe kuptova që i kisha rënë në shenjë.

- Fatkeqësisht natyra ka ligjet e saj dhe ne s'bëjmë dot gjë.

- Sikur..., - kuturisa unë të parën fjalë që më erdhi në mendje, por shpejt e kuptova se pas atij "sikuri" nuk vinte dot asnjë fjalë tjetër e kësaj bote.

- Eh, sikur, sikur..., përsëriti ajo.

- E ke takuar ndonjëherë nga afër? - pyetja më erdhi shumë e papritur, por për përgjigjen e saj unë isha përgatitur gjithë jetën... ashtu e kisha quajtur atë ditë, si më të rëndësishmen e jetës sime.

- Po, në Kongres, kur doli në fotografi me një grup gazetarësh.

- Ah, sa mirë! E kam parë atë fotografi.

Unë nuk dija ç'të thosha më tepër, por nuk ishte e nevojshme; si në ngut ajo shtoi:

- Nga diabeti i janë dobësuar sytë, ka vështirësi në lexim, prandaj... të zgjodhëm ty dhe... më kupton? Ai donte një njeri që e njihte bazën e të zgjodhëm ty... veteriner, shef edukimi, s'ka më mirë. Do të vish çdo ditë në orën njëmbëdhjetë në shtëpinë tonë dhe do të bësh një përmbledhje të shtypit të ditës e do t'i lexosh ato gjëra të veçanta që ai do të kërkojë."

*E gjithë bota kishte ikur prej meje dhe unë gjendesha në vrimën e zezë të kozmosit, pa gravitet, pa oksigjen, pa dritë.*

*“Çfarë do të bëj, çfarë?!”, doja të ulërija, nga frika dhe ndoshta nga gëzimi, por në atë imtë kuptova se isha edhe pa zë.*

*- Dhe, asnjë fjalë, me askënd!, - tha ajo dhe doli.*

*Unë doja të bëja një mijë pyetje, kur, si, pse, çfarë, por nuk kishte mbetur asnjë njeri i kësaj bote që mund të përgjigjej. Vetëm nëse e bënte Lenini i pikturës që, në atë moment, m’u përshfaq si ndonjë muzhik i dehur në “Leninskije Gori”.*

*Dhjetë minuta më vonë, a ndoshta një orë, nuk e di, kush mund ta dinte orën nga ajo vrima e stërmadhe ku po endesha pa peshë e pa frymë, erdhi një burrë i gjatë dhe simpatik, të cilin e kisha parë kushedi sa herë në lajmet e televizionit, si shoqërues të Udhëheqësit.*

*“Nesër, në njëmbëdhjetë pa dhjetë, do të vij të të marr.” Do të vij të të marr! Sesi m’u dukën ato fjalë. Do të të marr! E ku do të më shpjerë? Brenda lëkurës sime kishte hyrë një burrë tjetër që nuk më kujtohej se ku e kisha parë, madje nuk isha aspak i sigurt nëse e kisha parë ndonjëherë më parë. As në atë imtë nuk e shikoja, vetëm e ndieja se si ngatërrohej në rropullitë e mia. Ndoshta isha bërë edhe unë i verbër.*

*\*\*\**

*Më futën në vilë nga porta e prapme. M’u duk sikur po hyja në një botë tjetër dhe do ta kisha besuar këtë,*

*po të mos shihja një kopshtar që krasiste filizat e tepërt të trëndafilave. Pak më tutje qëndronte një ushtar i gardës, si një copë e ngrirë betoni, e mbështjellë me një pelerinë në ngjyrën e barit të tharë. Kisha dëgjuar një historikë të thartë për atë lloj pelerine. Thuhej se kur kishte ardhur mjeku francez për të vizituar udhëheqësin, kishte qëlluar një mbrëmje me shumë shi, nga ato shirat e pamëshirshëm të Tiranës, që zhurmonte lemerishëm mbi pelerinën e ushtarit. Sapo e kishte takuar të sëmurin e tij, doktori francez e kishte pyetur pse nuk bënin një kolibe për ushtarin, që të mos lagej nga shiu. Ashtu është më mirë, ia ktheu i sëmuri, ashtu ëndërron koliben, ndërsa po ta ketë koliben do të ëndërrojë të hyjë në shtëpinë time. “Edhe ti je si ai ushtari”, më thoshte dytësi im, që më ishte futur nën lëkurë.*

*Më lanë të prisja në një paradhomë, ku më ngelën sytë te një oxhak jo shumë i madh, bërë me disa zbukurime që të kujtonin stilizime të shqiponjës. “A nuk digjet kjo shqiponjë kur ndizet zjarri?”, pyeta ndërveti dhe në atë imtë kuptova se po lajthisja. Bëra sikur po rregulloja orën e dorës, por, në të vërtetë, i dhashë të majtës një pickim të fortë me të djathtën dhe sikur erdha në vete. Nga frika e ndonjë lajthitjeje edhe më të madhe ia ngula sytë oxhakut dhe nuk shikoja gjë tjetër. Por aromën e asaj paradhome e ndieja, ishte sikur të nuhatje një vjeshtë të vonë, kur bari është tharë, ose në vite me shira, është duke u kalbur. I alarmuar u përpoqa ta degdisja diku larg*

*atë mendim-nuhatje, andej nga kooperativa malore, ku kisha jetuar dhjetë a dymbëdhjetë vjet më parë... dhe tani? Përballë oxhakut dhe përpara derës së njeriut më të fuqishëm të vendit, pushteti i të cilit kishte arritur të prekte, madje edhe të urdhëronte, jetën dhe vdekjen tonë. Kushedi ku do të qorrollisej mendja ime e varfër, sikur të mos hapej dera dhe të më urdhëronin të futesha brenda. Akoma nuk isha ulur mirë në vendin që më treguan, kur dëgjova zërin e tij, krejt ndryshe nga sa e kisha dëgjuar në radio, mitingje apo kongrese. Nuk ishte ai zëri që vinte si bubullimë tribunash, por si një puplajë zogjsh, që largohej për diku, nën mëshirën e erës.*

*- Ç'lahje ka për naftën?*

*Isha krejt i papërgatitur për atë pyetje dhe nisa të shfletoja gazetën që i kisha marrë me vete. Ato të tijat ishin mbi tavolinë, të lagura aty-këtu nga pika çaji, kupa e të cilit ishte ende e pahequr. Ndoshta edhe nga pikëzat e limonit, mendova, kur pashë lëkurë limoni të shtrydhur. E ndjeva veten më keq se ajo lëkurë, por më ndihmoi fati dhe syri më kapi një titull shpëtimtar: “Brigada pararojë e naftëtarëve”.*

*- Pa ma lexo një çikë, - më tha kur ia tregova artikullin. Fillova të lexoj dhe në një grimë kohe u tmerrova. Për fatin tim, ai nuk e vuri re, në atë çast po shtrydhte pikat e fundit të limonit... “Brigada naftëtare që udhëhiqet nga brigadieri pararojë Hysni Pllum...” O Zot! Çfarë kanë shkruar kështu?! Në vend të “udhëhiqet” e kanë bërë “udhëqihet”. E*

*dija që ai gabim ishte bërë edhe një herë tjetër në një gazetë, gazetarin e kishin degdisur në një minierë, por askush nuk kishte guxuar të përmendte fjalën e gabuar; ishte nga ato që shkaktonte ethe malarike, ndoshta edhe ndonjë tërmet. Në atë grimë mua më zunë edhe tërmeti edhe ethet. Nuk dija ç'të bëja, ta lexoja ashtu siç ishte shkruar apo... Më dukej sikur i gjithë gjaku ishte grumbulluar në fund të trupit tim e po ngurtësohej si beton, ndërsa koka më buçiste. Ku, ku shkoi gjaku im? Kush ma vodhi? Oksigjen, oksigjen! Mezi po merrja frymë. Më shpëtoi një titull tjetër.*

*- Kanë shkruar edhe për kromin, - thashë me zërin që më dridhej si të isha ndonjë keç i uritur dhe rrugëhumbur.*

*- Pa hë...*

*- Kromi çan bllokadën. Tri fjalë që lindën një qytet...*

*U lëshova në rreshtat dhe kolonat e atij reportazhi ku tregohej për ngritjen e një qyteti të ri minatorësh, heroizmin e tyre, luftën me vështirësitë e nëntokës dhe të tjera kësodore. U lumturova kur vura re që po më dëgjonte me shumë vëmendje.*

*- Ma lexo edhe një herë atë historinë e inxhinierit italian.*

*Italiani kishte bërë kërkime dhe kur zbuloi gjurmët e kromit, kishte dërguar në Romë sahatin e tij, një monedhë floriri dhe një revolver. Sipas gazetarit, ky ishte një kumt i koduar që donte të thoshte se kam*

zbuluar flori, që koha nuk pret për ta bërë të tyrin, qoftë edhe me kobure, me luftë pra.

- Si non é vero, ben trovato! - tha ai dhe ia dha të qeshurit me zë. - Qerrata gazetar! - vazhdoi të qeshte.

Pse të gënjej? Nga e qeshura e tij lumturohesha, siç lumturohej një popull i tërë ose turma të mëdha të atij populli që, në vend të mishit e qumështit, hante dhe pinte buzëqeshje, kur udhëheqësi ishte në ditë të mira.

Në një gazetë tjetër lexova titullin “Qyteti i mollëve”.

- Oh, Korça, Korça e bukur, sa kujtime të mira kam... ti e ke njohur Poliksenin, teto Poliksenin?

Unë tunda kokën, që të mos kuptohej mirë nëse pohoja apo johnoja.

- E mirë, vazhdo...

Ç’të vazhdoja?! Nuk bëhej fjalë për Korçën, por për një qytet të vogël verior, në rrugët e të cilit, për zbukurim, në vend të pemëve dekorative kishin mbjellë mollë. Dhe qytetarët, të edukuar nga partia, nuk i këpusnin mollët, shkruante korrespondenti vullnetar i qytezës. Shpërthimi ishte i beftë.

- Ç’janë këta maskarenj, këta teveqelë, këta mutër, këta... si mund t’i vidhet Korçës emri “qyteti i mollëve”, dhe të degdiset atje ku ha pula gurë! Turp i madh! Të shkosh dhe t’u thuash të merren masa për këtë shtrembërim të realitetit. Urgjent!

Kuptova që seanca e parë e leximit kishte mbaruar. Ai hapi një album fotografish, mori një



*lente zmadhuese dhe nisi të kundronte pamjet. Kishte harruar që unë isha aty.*

*Dola dhe nuk dija ç'të bëja. Për qytetin e mollëve, po, do të shkoja në Sektorin e Shtypit dhe të jepja porosinë, por me atë brigadierin pararojë të naftës ç'të bëja. Për herë të parë kuptova se ka disa gjëra që është më mirë të mos i dish, të mos i shikosh dhe të mos i dëgjosh, përndryshe të nxijnë ditën dhe ta bëjnë sykapsoll natën. Kuptova edhe domethënien e shprehjes “të kesh frikë edhe nga frika jote”, të cilën nuk e pata tretur mirë, kur e lexova për herë të parë në një libër.*

*Kur përcolla porosinë për qytetin e mollëve, mendova të tregoja edhe për atë gabimin tjetër, por në imtën e fundit e rrëshqita mendjen tjetërkund. “Çfarë tha ai, çfarë porosie dha”, mund të më pyesnin. “Nuk ia lexova atë fjalë”, mund të thosha unë. “Kush je ti që vendos se çfarë i duhet lexuar e çfarë jo?!” Dhe nuk fola. Por jetova 24 orë ferri se mos dikush tjetër e zbulonte atë gabim fatal dhe merrej vesh që unë, në njëfarë mënyre e kisha mashtruar udhëheqësin. “U hutova”, mund të thosha. “Po pse të dërguam atje, të hutohesh?” “Nuk doja ta shqetësoja”, mund të thosha. “Ti?! Ti?! Ti e vendos këtë gjë?!”*

*Pas 24 orësh gazeta e asaj dite nuk ekzistonte më. Kur shkova të nesërmen tek ai, para se t'i bëja pasqyrën e shtypit, më ofroi një kupë çaji që më lumturoi; po, po, më lumturoi, pse të gënjej? Dita e dytë nuk pati asnjë problem, por unë nisa të kuptoj*

se në ç'lloj pune isha përfshirë. Vija re që, nga çasti kur dola prej zyrës së shtypit, ku kisha çuar porosinë për “qytetin fatkeq të mollëve”, të gjithë më shikonin disi ndryshe, ose ndoshta mua më dukej ashtu? Jo, jo, nuk më dukej, ishte e vërtetë, isha bërë si hëna që shikohet natën, për të marrë vesh si do të ishte koha të nesërmen. “Ka vënë rreth hëna?” “Jo, nuk ka vënë, do të jetë kohë e mirë nesër.” Edhe vetë sekretari i propagandës së madhe, në ditën e katërt, më thirri në zyrë dhe, pasi më pyeti për mollët, naftën dhe kromin, më përcolli duke më vënë dorën në sup. “Kujdes, ke një detyrë delikate dhe të rëndësishme.”

Hajde, Fitim Zagora, hajde! Në çfarë shtegu ke arritur. Por kujdes, kujdes se po rrëshqite, nuk ka Zot që të shpëton nga gremina. Dhe ditë pas dite unë po kuptoja se në atë farë pune ku më kishin thirrur, rreziku rrinte gjithnjë prapa derës, ishte si në malin e vetëtimave, atje në kooperativën e largët: ti je duke iu gëzuar diellit, kur, papritur, shkrepitjnjë retë e bubullijnë malet dhe luginat, shtrëngata lëshon kamxhikët e saj mbi tokë dhe pemë, a thua se do të përmbysset bota. Fati më kishte shpëtuar një herë nga rrufeja, në ditët e para kur shkova në kooperativën malore. Dy burra po pinin cigare nën hijen e një dardhe të vjetër. Unë shkova dhe kërkova të ma ndiznin cigaren. “Shko tek ato gratë, ato kanë çakmak”, më tha njëri nga burrat, me siguri për t’u tallur me mua, çunakun e shkolluar dhe pak lehtan ose tyryfyl, siç më quante ai. Ishte po ai që në ditën e parë, kur e

*takova dhe e pyeta si shkojnë punët e kooperativës, më pat thënë se të gjitha shkonin mirë, përveç një halli të madh, nuk po na pjell asnjë mushkë, mbase do t'ua gjesh ti dermanin me shkollën e madhe që ke... Shkova te gratë, pak metra më poshtë dhe kur unë po ndizja cigaren, qielli ndezi një vetëtimë të frikshme që përvëloi trungun e dardhës dhe njërën faqe të tallësit tim. Nuk vdiq, por goja i iku përgjithmonë. Po me rrufetë e këtushme si do të më shkonte fati?*

*Një mëngjes e gjeta plot humor, më tregonte plot gjëra nga kujtimet që shkruante, ose ia shkruanin të tjerët duke zbardhur incizimet e shumta të bisedave të tij, më ofroi çaj dhe kek dhe unë mendova se ajo ditë do të ishte e lumtur për mua, në ato çaste, por edhe më vonë, në kujtimet e asaj dite. Por nuk qe e thënë të hajë dervishi mish lepuri. Fajin e kisha vetë, ç'mu desh t'i lexoja një përshkrim për një ushtarak të lartë, që kishte vdekur pak ditë më parë... Ai u vrenjt dhe kur unë lexova këngën kushtuar ushtarakut dhe fjalën shqiponjë me të cilën gazetari e cilësonte shefin e forcave të armatosura të atij rrethi, udhëheqësit i kcyngacat, shpërtheu gjithë inatin e botës:*

*- Shqiponjë?! Ai Shqiponjë?! Ai ishte një zagarr buçesh, asgjë më shumë. Ma hiq sysh!*

*Më ngeli pykë në mendje ajo ngjarje. Por nuk mund të dija asgjë më shumë, s'kisha nga ta merrja vesh. Por si i thonë, rastësia është shtegu i domosdoshmërisë. Kur dola nga puna, po kaloja pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe papritur u takova me një shokun tim*

*agronom, që jetonte e punonte në atë rrethin ku kishte vdekur “shqiponja” e ushtrisë për të cilin ishte thurur edhe kënga...*

*Për ty po qan Shqipëria  
Vdiqe ku të deshi partia...*

*- Ku je, o Agoll? - e pyeta shokun tim të viteve studentore.*

*- E ku të jem? Aty ku më deshi partia.*

*Kuptova se ai e dinte tashmë ngjarjen dhe këngën.*

*E ftova për kafë. Nuk ishte e nevojshme t’i vija rrotull për të dëgjuar atë që më gërryente në thellimet e mia të brendshme. Edhe kur ishim studentë, e mbaja mend mirë Agollin, gjithnjë do ta shihja mes shokësh, duke u treguar diçka që i bënte të gajaseshin... Menjëherë, pasi gjerbi hulmin e parë të kafesë, la filxhanin dhe nisi të më tregojë:*

*“E di si ishte puna? Kur isha agronom në malësi, një burrë vdiq mbi të dashurën lakuriq. Heshtje e madhe përpara kufomës, kisha shkuar edhe unë për ngushëllim. Asnjë nga burrat nuk fliste, asnjë nga vajtorët nuk po i rendiste bëmat e jetës, siç ishte zakoni andej. Më në fund e theu heshtjen rapsodi më i vjetër:*

*O i miri i më të mirit,  
O stërnip i Marka Mëhillit,  
Që i qiti pushkë Vezirit,  
T’iku jeta n’bir të pidhit...*

*Pasha at'diell e pasha at'hanë*

*Atë punë e bajmë të tanë,*

*Por, shyqyr, nuk na kanë zanë!*

*Edhe këtë 'shqiponjën' për të cilin po më pyet, e zuri vdekja lakuriq mbi pidh. Me një grua të bukur si Margarita. U lajmërua sigurimi i shtetit dhe, për të mos e parë fqinjët, e nxorën kufomën nga dritarja. Por, kur e veshën, ia ngatërruan rrobat me ato të burrit të tradhtuar, të cilat i rrinin të gjata e të gjera... Gruaja e tij nuk thoshte asnjë fjalë, vetëm shikonte mëngët e xhaketës së një burri të panjohur mbi gruan e të cilit kishte vdekur i shoqi i saj. Dy-tri plaka bënëin zakonin, duke renditur ato fjalë që më vonë i tregonin nëpër klube... 'Oii, oii, vdiqe ku të deshi partia, për ty po vajton Shqipëria''.*

Borjana Damati ndjeu sikur iu mbush fytyra me puçrra ironie dhe e ndërpreu leximin e kujtimeve të Fitim Zagorës.

Një infermiere hyri në dhomë nxitimthi dhe, si me pëshpërimë, i tha:

- Ju kërkon drejtori në zyrë.

U kthye menjëherë dhe u largua po aq e nxituar, për të mos i lënë kohë doktoreshës Damati t'i kërkonte ndonjë shpjegim. Kjo shmangie e dukshme e infermieres e shqetësoi. Në zyrën e drejtorit gjeti një paciente të pavijonit të saj.

- E njeh këtë? - pyeti drejtori pa u përshëndetur fare.

- Si nuk e njoh, kam tri javë që po e kuroj.

- Ajo kërkon të largohet nga pavijoni i saj, nga pavijoni juaj, më saktë.

- Drejtor, unë... - nisi të thotë diçka e sëmura, por drejtori nuk e la të vazhdonte.

- Ju shkon në dhomën tuaj, kam punë me doktoreshën, - tha, dhe akoma pa u mbyllur dera, iu turr Borës. - E shikon ç'na bëre?! Pacientët duan të ikin nga pavijoni yt. Edhe gazetë italiane kanë shkruar për rastin tënd.

- Ai nuk është rasti im.

- Po i kujt na qenka?!

- I të gjithëve, i gjithë botës. Në atë Italinë që më përmendët kanë vrarë veten edhe mjekë, mos doni që edhe unë të vras veten?

Drejtori nuk e zgjati më tej, vetëm urdhëroi që e sëmura që ankohej të shtrohej në një pavijon tjetër, ndoshta do të ishte më mirë të sistemohej në njërin nga pavijonet e katit të parë. Kërkesa e fundit e drejtorit e tronditi Borjana Damatin, por nuk pati as dëshirë, as vullnet e fuqi ta vazhdonte atë bisedë. E vështroi edhe një herë fytyrën e drejtorit dhe iu duk e mërzitshme si një ditë me shi shkodre. Por, një nënqeshje hipokrite, ndërkohë që lëmonte mjekrën, dhe shikimi diabolik i tij e shqetësuan Borjanën. *Barba non facit philosophum!* - pëshpëriti në latinisht duke iu rikthyer zakonisht të saj të hershëm që kur e studionin atë gjuhë në fakultet. Edhe pse kishin kaluar shumë vite, u ndje e vetëpërkëdhelur, ngaqë kishte qenë studentja më e mirë e asaj gjuhe të vdekur.

Doli më e mërzitur se kurrë dhe ndjeu se po i pakësohej sheqeri në gjak. Sikur po i fikeshin sytë.

Pavijonet e tjera nuk kishin asnjë vend të lirë. Apo nuk pranonin të sëmure nga pavijoni i saj? Të gjithë shefat e pavijoneve i kishte mbuluar kuskuta e smirës qyshse ministri, dy muaj më parë, pat shkruar në faqen e tij të *Facebook*-ut ca fjalë të mira për Borjanën dhe ata (por edhe më shumë drejtori) kishin menduar se ajo mund të bëhej një ditë edhe drejtoreshë. Ishin nga ata që pëshpëritnin: “U thye edhe qypi i Borjana

Damatit!”. Kur ajo këmbënguli me njërin prej shefave që të gjendej një vend, se ishte urdhri i drejtorit, se e sëmura ishte shumë e shqetësuar e të tjera fjalë kësodore, ai ia preu shkurt:

- Sapo të hidhet ndonjë nga ballkoni, lirohet një vend, sigurisht.

Bora e mbylli telefonin mbushur pezm dhe inat; nuk po kuptonte se për çka e kishte fjalën kolegu, për ndonjë hedhje tjetër nga ballkoni i saj, apo për ndonjë të re në pavijonin e tij. Inati iu zbut kur hamendësoi se ndoshta edhe në pavijonet e tjera kishte probleme të asaj natyre, siç kishin ndodhur me dy të sëmuret e saj. Kushedi ç’po ndodh? Por i shtyu ato mendime diku në cep të trurit, që sigurisht do t’u kthehej përsëri dhe shkoi tek e sëmura që kërkonte të largohej nga pavijoni i saj. U përpoq ta qetësonte disi dhe i premtoi që të nesërmen, edhe po të mos lirohej ndonjë vend, ajo do ta gjente një zgjidhje.

- Nuk mundeni sot? - foli e sëmura dhe në zërin e saj ndihej një trishtim funerali, përzier me ankth.

Gjatë gjithë ditës doktoresha shkoi disa herë në dhomën e saj, duke folur me të sëmura të tjera dhe me atë vetë dhe, aty nga pasdreka, iu duk më e qetë. Vetëm sytë ruanin akoma alarmin e mëngjesit, prandaj, para se të largohej për në shtëpi, thujse me të lutura, porositi mjekun e rojës ta kishte kujdes të sëmurën.

- Çfarë të ka gjetur, Zize, moj e zezë! - deklamoi mjeku sikur të ishte në teatër. Të gjithë e dinin se



Bernard Bimo shkoi në Fakultetin e Mjekësisë pasi humbi në konkurrimin për t'u pranuar në Institutin e Artit Dramatik. “Dhe tani më reciton këtu për Azizen e shkretë”, mendoi Bora. Por ai zë e ato fjalë i buçisnin në brendësi të qenies gjatë rrugës, edhe në shtëpi. “Çfarë të ka gjetur, Zize, moj e zezë!”

“Çfarë... çfarë...?”

Si për të hequr mendjen nga Zizja, filloi të shfletonte përsëri shënimet e Fitim Zagorës, por e mërzitën ato përsiatje dhe vrasje ndërgjegjeje të një burri që kishte pasur frikë edhe nga frika e vetes, që nuk kishte bërë gjë tjetër, vetëm se kishte lexuar pasqyrën e shtypit të ditës për Atë, të cilit nuk guxonte t'ia shkruante as emrin. E hodhi diku atë fletore, por i erdhi keq për gruan që ia kishte sjellë, për gruan e Fitim Zagorës që ndiente keqardhje jo vetëm për të shoqin e vetëvlarë, por edhe për telashet që i kishin zënë rrugën dokoreshës. “Më kishte lënë porosi t'ia fusnim në arkivol këtë fletore.” Iu kujtuan fjalët e gruas të veshur me të zeza. Borjana nuk e ngacmoi me pyetjen zhbiruese: pse? Por ajo vetë sikur i tha diçka, një gjë që Borjana nuk e kishte fiksuar mirë. “Le të zbresë në varr bashkë me mua edhe kjo pendesë.” Diçka të tillë sikur më tha. Por në ato që lexova sikur nuk pashë ndonjë pendesë, a ndonjë barrë, ndoshta vjen diçka e tillë në faqet e mëtejshme... *Nga supet si ta hedh këtë barrë?* Ah, po! Ndoshta akoma jetonte me poezitë që kishte lexuar dikur. Edhe ky varg ishte nga një poezi e Kadaresë për një zë që vinte si nga

nëntoka. *Ku ta hedh këtë peshë, si?* Borjana e kërkoi në internet atë poezi dhe e gjeti shumë shpejt:

*Me të s'mund të zbres atje poshtë*

*Por as lart dot s'e lë kursesi.*

Kjo do ta këtë munduar edhe Fitim Zagorën që paska lënë porosi ta varrosin bashkë me të edhe atë fletore shënimesh që tani ndodhej mbi divanin e saj. Nuk e hapi. Ndoshta ndonjë ditë tjetër, mendoi dhe kërkoi ndonjë film të mesnatës në televizor. Gjeti diçka me temë familjare por, ngaqë po e shikonte shtrirë, dremiti. E zgjoi një zile telefoni. Ajo kujtoi se po binte zilja e ndonjë personazhi të filmit, por shpejt e kuptoi se ajo tringëllimë ishte e telefonit të saj. Dëgjoi një zë të alarmuar. Nuk ishte as mjeku i rojës dhe as ndonjë nga infermierët, por një pacient.

- Doktoreshë, të lutem doktoreshë, Zizja...

- Çfarë?

- A mund të vini?

Ajo e mbylli telefonin dhe kërkoi menjëherë shërbimin e taksive të natës. Në korridor e priste njëri nga të sëmurët, një burrë rreth të gjashtëdhjetave, që nuk ankohej kurrë dhe që në jetën jashtë spitalit kishte qenë përkthyes në Ministrinë e Jashtme, por pasi e hoqën nga ajo punë, përkthente romane dhe poezi vetëm nga shkrimtarët e Amerikës Latine.

- Çfarë ka ndodhur, Petro? - pyeti Bora e shqetësuar.

- Azizja nuk duket mirë... u afrua disa herë te ballkoni... dhe tani natën... më trembi shumë, prandaj telefonova. Më falni, por...

“Çfarë të ka gjetur, Zize, moj e zezë?!”, përsëriti kushedi për të satën herë, Borjana Damati.

- E njeh? - e pyeti Petron.

- Pak për jetën jashtë spitalit, diçka më shumë këtu.

- Pse e bën këtë?

- Ka qenë shumë mirë, por ka dy ditë... ka ndryshuar krejt.

- Përse vallë, kura nuk i ka ndryshuar, parametrat i ka afër normales.

- Se ç’ndien një gjë... si ta them, sikur e ka ndonjë molë përbrenda, apo diçka që i shtrëngon fytin dhe i shtyp kraharorin... si të gjithëve xhanëm, por më shkon mendja në diçka që ndoshta e kam edhe gabim... Pendohe mi të gjithë për ato që bëmë dhe nuk i bëmë. Më tha, kam një eshkë të ndezur në kraharor, nuk e shuan as uji, as era.

- Çfarë, më thuaj.

- U përkeqësua këto dy ditë...

- Nga dy vetëvrasjet? - pyeti me ngulm Borjana.

- Jo, jo. Që atë ditë që u shtrua këtu ai, Zenun Vëngu... Ka ndryshuar krejt dhe përpiqet t’i shmanget çdo vështrimi të tij, çdo bisede për të.

- Njiheshin më parë?

- E pyeta, por nuk më tha asnjë fjalë. Ndoshta njiheshin, por nuk e kuptoj pse i shkakton atë ankth e makth drithërues prania e tij në spital. E di si më tha? Po më digjet bota në lugth të kraharorit.

- Ka kërkuar të largohet nga pavijoni im.

- E dija, - tha Petro, - por nuk ka të bëjë me ty, kërkon të ikë sa më larg Vëngut. E di unë se ç'është ai! Na erdhi këtu si gjarpri në Galapagos, - tha dhe i tregoi doktoreshës se si njëherë, në ishullin Galapagos, ku Darvini kishte studiuar origjinën e specieve dhe ato mbaheshin të paprekura, si në kohën e shkencëtarit të madh, u hap lajmi se dikush kishte lëshuar fshehurazi një gjarpër. U bë alarm i madh në gjithë botën. Gjarpri do të shkatërronte gjithë atë areal dhe ekuilibër që mbrohej prej dhjetëra apo qindra vjetësh nga bota shkencore, nga UNESCO e organizma të tjerë. Do të shkatërrohej gjithçka që i kishte shërbyer Darwinit të shkruante teorinë gjeniale të evolucionit. Për njëfarë kohe u qetësuan pasi doli fjala se gjarpri ishte mashkull, por dolën të tjerë që thanë se ishte femër dhe mund të mbushej gjithë ishulli me vezë gjarpërinjsh..., me gjarpërinj, që do ta shkatërronin vlerën shkencore të tij...

Borjana Damati e falënderoi Petron dhe shkoi në dhomën e të sëmurëve. Vetëm Azize Murga ishte syhapur dhe shikonte tavanin; e cërrukur në shtrat, sikur të ishte në mes të acarit. Bora vuri re se dejëzit e syve i ishin përskuqur. E preku në ballë si për të provuar temperaturën, pastaj u ul në cep të krevatit. Qëndroi pa lëvizur, pa bërë asnjë pyetje, derisa vetë Azize Murga ngriti perden e jetës së vet.

K ishte pasur një dashuri dhe martesë të lumtur. Mendonin se në të katër cepat e kësaj bote nuk mund të gjendej një çift i tillë, i bukur, i mençur dhe i gatshëm për të sakrifikuar shumëçka, vetëm e vetëm që ta gëzonin jetën bashkë e të bënë një familje sa më të qetë e të këndshme. Edhe pse pagat e tyre nuk u lejonin jetë luksi, por një lumturi të racionuar, ata gjenin mënyra për t'u gëzuar. Çdo pesëmbëdhjetë ditë, kur merrnin rrogat, bashkë me racionin e mishit apo të pulës, merrnin edhe dy-tri shishe me verë *Risling* dhe pinin e këndonin të dy bashkë, aq bukur sa edhe fqinjët hapnin dritaret për t'i dëgjuar. Nuk i dehte vera, por gëzimi që kishin gjetur njëri-tjetrit, që ishin bashkuar në martesë dhe që mendonin se do ta kalonin tërë jetën pranë njeri-tjetrit. Shumë shpejt, pa i mbushur njëzet vjetët ajo dhe njëzetetre ai, u lindi fëmija e parë, një vajzë si drita, por që u shua shumë shpejt, pa mbushur asnjë ditë të plotë, pa arritur t'i vinin as emrin, njërin nga emrat e shumtë që kishin menduar. Shpirti i të voglës, me të cilin Azizja

bisedonte dhe ofshante çdo ditë, u bë brajz<sup>1</sup>, derisa mbeti shtatzënë për të dytën herë. Djalin, një fëmijë i shëndetshëm, bacung, e lindi atë mëngjes, kur e gjithë Shqipëria ishte veshur në zi, sapo u dëgjua lajmi se kishte vdekur udhëheqësi i madh i diktaturës së proletariatit në vend. Ishte 11 prill 1985, ditë e ftohtë sikur të kishte rënë breshnizë kahmos.

Ditë e bekuar apo e mallkuar? Këtë pyetje ia bënë vetes Zizja me të shoqin, kur shkuan në gjendjen civile të regjistrin djalit e sapolindur. “Kur ka lindur?”, pyeti nëpunësja e gjendjes civile. Ata i treguan datën.

“Atë ditë ka vdekur shoku Enver”, foli e murrëtyer ajo. Ata nuk folën, sepse, në të vërtetë, nuk dinin ç’të thoshin për atë përzierje makabre të një vdekjeje dhe funerali të tejperzishëm me gëzimin e tyre për lindjen e djalit.

- Doni ta regjistroj më 10 apo 12 prill? - pyeti nëpunësja.

- Ka lindur më 11 prill, moj shoqe, të thamë, apo nuk dëgjove? - tha i shoqi duke parandier atë çka po mendonte burokratja e vockël e gjendjes civile. Zizja ia nguli sytë fundit të zi dhe një trikoje në jeshile të mbyllur, për të lënë përshtypjen e zisë për vdekjen dhe vdekatarin e famshëm.

- Unë dëgjoj shumë mirë, por ju nuk dëgjoni, ose nuk doni të dëgjoni! Atë ditë ka vdekur shoku Enver,

---

<sup>1</sup> Shpirti i fëmijës që vdes pa emër. (Shën. i autorit.)

atë ditë nuk mund të kishte asnjë gëzim! - foli ajo si në ndonjë mbledhje të organizatave të masave, në ato ditë zie kombëtare, por edhe me një pamje prej shenjtojeje që i jepte vetes, edhe pse ishte një brecujë<sup>1</sup> thatanike.

- Por udhëheqësi i ri, ai i vazhdimësisë, ka thënë që për shokun Enver nuk ka datë vdekjeje, por vetëm datë lindjeje. Edhe në pllakën e varrit ashtu kanë shkruar, - nuk po dorëzohej babai i djalit të sapolindur.

Por, aq sa mund të luante shkëmbi, aq luante edhe Shkëndija, shoqja Shkëndo e gjendjes civile. Ata të dy kundërshtuan edhe njëherë dhe nëpunësja nxori një certifikatë lindjeje dhe nisi ta plotësonte, kështu, ata u gëzuan që, më në fund, iu mbush mendja.

- Emri i babait? - pyeti.

- Bekim Murga, - tha Zizja, duke vënë re që të shoqit akoma nuk i qenë zbutur nervat.

- Emri i nënës?

- Azize Murga.

- Emri i djalit?

- Blerim Murga.

Ajo i shënoi të gjitha, vuri një vulë dhe u zgjati certifikatën. Zizja e mori në dorë e gëzuar, por Bekimi ia rrëmbeu nga dora dhe e grisi.

- Nuk të lejoj t'i ndërrosh datëlindjen djalit tim!

Ai e kishte vënë re se në certifikatë ishte shënuar 12 prilli si datë lindjeje.

---

<sup>1</sup> Grua e imët. (Shën. i autorit.)

- Atëherë shkoni në *esfel* dhe regjistroni pjellën tuaj! - thirri me një gërricje ndryshku në fyt nëpunësja e gjendjes civile. Dolën, por dielli i bukur i prillit nuk ngrohte më për ata, as bari nuk mugullonte që t'ua bënte më të bukur atë ditë. Për herë të parë, qysh se ishin njohur, po ecnin të pakapur dorë për dorë. Diçka e egër, e rrëshqitshme si lëkurë kërmilli, kishte hyrë në mes tyre dhe u dukej se po shkonin në një funeral. Zizja u drodh nga parandjenjat që e kapluan, parandjenja që si për çdo nënë, ceknin vetëm të papritura fatkëqija për të birin. Iu bë se dëgjoi të qarën e brajzit të së bijës. Sikur ndillte trishtim e dhimbje.

Një mëngjes me mjegull të trashë e të ftohtë u dëgjuan trokitje të forta në derën e tyre. Ishin tre burra të panjohur. "Nuk e mbaj mend, a thanë jemi policia apo jemi prokuroria, por shtëpinë tonë të vogël e kthyen përmbys. Djali qante dhe unë nuk dija si ta qetësoja." Zizja ngriti sytë për të parë doktoreshën dhe Bora pa lotët që binin ngadalë. I shoqi i Zizes u nevrkos edhe një herë, kur ata zunë të kontrollojnë bibliotekën duke i hedhur librat në fundshtrojë si lecka mekanikësh.

- Ngadalë, ç'faj kanë librat?

- Ato e kanë gjithë fajin, pa shiko ç'mban! *Bel-Ami. Tre shokë*. Aha... paske edhe *Lahutën e Malsisë*, - tha njëri nga kontrollorët.

- Po kjo *Qerbelaja* ç'është?

- Dhe në gjithë bibliotekën, asnjë vepër e shokut Enver! - tha tjetri. I treti nuk fliste, por ai



kishte vështrimin më kërcënues, që rrëshqiste për nënvetull si gjarpri nën gur. Ishte ai, Zenun Vëngu. Kur u larguan, përveç librave që i ngarkuan në një kamion, morën me vete edhe Bekim Murgën. Zizja ia dha piskamës dhe të gjithë banorët e shkallës dolën përjashta. Smira dhe keqardhja ishin përzier si retë e marsit që përplasen në kohën e ndërrimit të stinëve. Azize Murga kaloi tri ditë tmerri dhe shprese, por të katërtën shpresa u zhduk dhe mbeti vetëm frika e llahtarshme e së panjohurës së varur në buzën e një gremine. Kishte frikë për vete, për të shoqin, por shumë më tepër për atë kërthinjë disaditëshe që, me të qarën e paprerë, dukej sikur mallkonte botën ku kishte ardhur pa dëshirën e tij dhe që e kishte pritur edhe ajo me mallkimin më të egër: *Mbetsh jetim me babanë gjallë!*

Ditën e katërt erdhën dhe e morën, e hipën në një kamion dhe pas disa orësh e çuan në një kamp internimi, për të cilin ajo nuk pati as grimën e dëshirës që t'ia mësonte emrin. Ndryshon gjë emri?! Ndaj Bekimit kishte filluar një proces hetimi, e mbanin mbyllur në qeli, nuk lejonin asnjë takim, dosja nisi të mbushej, në fillim me ngjarjen në gjendjen civile, pastaj u shtua edhe një darkë me tre-katër shokë që ai i kishte ftuar të pinin birrë te *Vollga e vogël*, në ditën e lindjes së djalit, pra në ditën e vdekjes së diktatorit, ku edhe kishin kënduar. “Kënduat në ditën e zisë për shokun Enver!”, bërtiste hetuesi; pastaj ca libra të dyshimtë, dikush deklaroi edhe për disa revista të huaja; “me

nudo, apo jo” pyeste hetuesi dhe tjetri lëvizte kokën si për t’i thënë ashtu siç i do ti në dosje, ashtu ishin; ndonjë fjalë për mishin dhe preshin që mungonin në treg dhe kështu, pingu i dosjes u bë i tillë, sa e zu nën vete atë burrë të shkretë që kurrë nuk kishte menduar t’i bënte keq ndokujt. Kishte dashur të ndërtonte dhe të mbronte vetëm çerdhen e vet, ndërkohë që tani po e shikonte me një trishtim të përmortshëm, të hedhur e të shkelur në mes të rrugës. Dhe dy zogj cicëronin vajtueshëm në kërkim të asaj çerdheje, që kurrë nuk do ta gjenin më atje ku i kishin çuar, në atë kamp internimi, ku mushkonjat të pinin gjakun, balta ta hante lëkurën dhe era të thante kockat.

Dhe pikërisht atje u shfaq përsëri Zenun Vëngu. Ishte një vjeshtë e tretë dhe në qiell përplaseshin retë e shtrydhnin një shi të ftohtë.

- Tri herë ma ka përmbysur botën! - tha Zizja. - Atje në kampin e internimit më ndodhi rrënimi i parë. Dy gjëra nuk kishin ndryshuar: e qara e djalit dhe vështrimi si gjarpri nën rrasë i hetuesit.

- Don ta rritësh këtë djalë, apo ta varrosësh në këto baltëra? - i ra drejt e në kokë ai. - E ke vetë në dorë, - i tha dhe i kërkoi që të bënte një deklaratë kundër njeriut më të dashur të saj në këtë botë. U tromaks, u mblodh kruspull dhe mbeti ashtu, e ngructë dhe pa fjalë. Të nesërmen, të pasnesërmen dhe disa ditë të tjera ai erdhi prapë. Një ditë madje solli edhe një shishe qumësht për djalin. Donte t’ia thyente mbi kokë, por të gjithë muskujt dhe nervat, deri në majë

të gishtërinjve, i kishin ngrirë. Vetëm qante dhe nuk thoshte asnjë fjalë.

- Në gjyq nuk do të dalë emri yt, - i tha hetuesi për ta bindur. Po unë a mund ta harroj emrin tim, a mund të harroj se çfarë kam nënshkruar? Këto pyetje i kacavirreshin në trup e tru. - Nesër do të vij për herë të fundit, - i tha Vëngu dhe u largua duke lënë varur kërcënimin e tij në çdo cep të barakës së kampit të internimit. Nuk dinte si do ta gdhinte atë natë, por shpejt harroi gjithçka, kur vuri re fytyrën e lëmekur të djalit. I vuri buzën në pllangat e ballit dhe ndjeu përvëlumin e temperaturës. Nga e kuqja, fytyra po merrte një të jeshilët tmerrndjellëse dhe, pa kuptuar se ku po shkonte, doli në mes të barakave të tjera duke vënë kujën.

- Kuku për djalin! Kuku...

Të internuarit e tjerë e ndihmuan me ç'të mundnin. Dy gra, nënë e bijë të internuara, i sollën dy copa hithnik për darkë dhe nuk e lanë vetëm për gjithë natën.

- Ç' do të bësh, moj e zezë? Ke mbetur kërcënik në këtë botë! - i tha disa herë plaka.

Kur erdhi Zenun Vëngu për "herë të fundit", siç kishte thënë, ajo e pyeti e para, pa prituri që ai të pyeste se çfarë kishte vendosur.

- Do më ktheni në shtëpi?

- Patjetër, ne kujdesemi për të ardhmen e fëmijëve.

- Ma sill atë paçavure ta firmos, - tha me zërin e lagur prej lotëve.

Ai hapi një çantë të zezë, nga ato që u jepeshin delegatëve nëpër kongrese, nxori letrën, stilografin dhe ia zgjati të mbështetur mbi çantë. Azize Murgës iu duk se po nënshkruante letërnjoftimin e vdekjes së vet, nën këmbë ndjeu dheun e butë të varrit të saj të sapohapur... *Ngreu, moj nuse e vogël, ngreu e ndizna zjarrë/ ta shoh nana Zizen/ sa plumba ka marrë...*, futi veten në trungun e tharë të një kënge të lashtë.

Bekim Murga u dënua me shtatë vjet burg. Prokurori kërkoi tetë sipas ligjit për agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit, por gjyqtari i uli një vit “për sjellje të mirë familjare”, siç lexoi në vendim, duke hedhur një vështrim asgjësues mbi një truc kockash dhe muskujsh, të palëvizur në cep të sallës, që quhej Azize Murga. Asaj përsëri, nuk e kujtonte më për të satën herë, iu duk sikur ishte aty në varrimin e vetvetes. Dhe çuditej pse gjendej vetëm. Nuk kishin ardhur as babai dhe as dy vëllezërit që ta varrosnin, nëna kishte vdekur pak muaj përpara, kur Azizja ishte ende në kampin e internimit. “Unë nuk isha në varrimin e nënës dhe ata nuk erdhën në varrimin tim. E kush do të më hedhë një grusht dhé? A ka mbetur dikush në këtë botë që të sjellë lule për mua? Kush do të m’i mbyllë sytë? Do të më varrosin me sytë hapur, o Zot, m’i shpëto nga krimbat!” Kur doli nga kllapia e vetëvarrosjes, u kujtua se babai dhe vëllezërit nuk kishin ardhur për të “ruajtur të pastër biografinë e tyre”. Që në ditën e parë të arrestimit të Bekimit ata e kishin thirrur në shtëpi dhe ngulën këmbë që

ajo ta ndante menjëherë, sepse “nuk mund të jetonte nën të njëjtën çati me një armik të pushtetit”. Por ajo nuk pranoi: “Kam një fëmijë me të, nuk mund të bëj asgjë”. “Na more në qafë!”, i thanë dy vëllezërit, të cilët punonin diku në zyra të shtetit dhe trembeshin se mund t’i degdisnin andej nga nuk do të ktheheshin dot më. Babai nuk fliste, por ajo heshtje i rëndonte më shumë se çdo fjalë që mund të thoshte. Kur po ikte, ai, fshehurazi nga djemtë, i vuri në dorë lekët që kishte kursyer nga pensioni dhe i tha vetëm dy fjalë: “Kujdes djalin!”.

E trazoi nga ndërmendja e atyre dialogëve zëri i gjarprit fishkëllyes, Zenun Vëngut. “E ulëm një vit për sjelljen tënde. Mund të ketë edhe ulje të tjera, por kjo varet nga ti, nga puna që mund të bësh për ne... për shtetin, dua të them”, shtoi në fund, kur pa një nerv që shtrembëroi vetullat e Azizes. Ajo u ngrit dhe u largua pa folur. “O Zot, mos ardh të kush në këtë derë!”, foli me vete Zizja fatzezë.

Vetëm pas gjashtë muajsh i dhanë lejë për të takuar burrin, në burgun e Qafë-Barit. “Edhe varrit do t’ia tregoj atë udhëtim”, do të thoshte më vonë. E vetmuar, e trembur, e nëpërkëmbur, po bënte udhëtimin e parë drejt ferrit. Kishte një vuajtje të dyfishtë: të ferrit dhe të fajit. Burgu ishte në fund të një gryke mali dhe mbi të dukej vetëm një jorgan qielli; e gjithë dita nuk ishte gjë tjetër, *vetëm dhjetë minuta diell*, siç i tha Bekimi, kur u takuan. “Por as atë nuk na lënë ta gëzojmë, që pa lindur dielli futemi në minierë dhe dalim bashkë me

natën. Na bren uria, që është më e pamëshirshme edhe nga vdekja, etjen e shuajmë kur retë ndiejnë dhimbje për ne...” Ajo dëgjonte e çmeritur dhe shikonte me bisht të syrit katër ngrëhinat ku mbaheshin të burgosurit, tre dykatëshe dhe një trekatëshe. Pak më tutje ishte një mur i madh, mbi të cilin ishte ngritur një masiv betoni, prej nga zgjateshin tri gryka të mëdha metalike. “Po ato?”, pyeti Zizja.

“Është vendi i shkarkimit të mineralit. E sjellim nga galeritë, duke shtyrë vagonët me krahë dhe pastaj vijmë skodat e ngarkohen aty, nën ato gryka. Quhet *tremozhë*, por të burgosurit e quajnë *tmerrozhë*.” Menjëherë Bekimi filloi të pëshpëritë. “Është jetë ferri këtu, nuk durohet. Po nuk ika dot, do të vras veten dhe ti shiko jetën tënde, kujdesu për Blerimin.” “Si do të ikësh, as gjarpri nuk del dot prej këtu”, i tha ajo. Por ai hodhi sytë mbi atë që e quanin *tmerrozhë*, pa thënë asnjë fjalë tjetër.

Dy ditë më pas, Zizen e thirri Zenun Vëngu.

- A u çmalle me burrin? - e pyeti shumë serioz, sa të thuash që po interesohej me sinqeritet dhe përzemërsi. Por ajo nuk u përgjigj se e dinte mirëfilli çfarë shpirti fshihej në atë zë që, edhe kur ishte i qetë e serioz, gjithnjë i kujtonte fishkëllimën e gjarprit. Përmes xhamave të pistë hodhi një vështrim përtej telave me gjemba, në tejanën e burgut. Nuk vonoi asnjë grimë kohë e ajo dëgjoi në brendësi të kokës thirrjen e asaj fishkëllime:

“Tani do të më thuash fije e për pé çfarë bisedoi burri me ty”. Edhe pas pyetjes së tretë të tij, ajo

nuk i tregoi asnjë fjalë. Kur u largua, e kaploi frika, sidomos pas paralajmërimit kërcënues: “Mirë, do të shihemi përsëri! Ta dish, nuk ka blerim në acar”. Ku të shkonte, ku të fshihej? Edhe me u mshelë si arra në gëzhytër, ai do ta gjente. “Veç me e marrë kryet nën sqetull e të zhdukem kësaj bote”, mendoi.

Shumë gjëra ia trazuan shpirtin pas atij takimi. Natën zgjohej e tromaksur se shikonte në oborr makinën e internimit, një “zis” apo “zil”, nuk e kujtonte, por që targa i qe fiksuar në çdo cep të trurit: 0033. Një numër i tmerrshëm, që i kujtonte “Ferrin” e Dantes, ashtu siç ia kishte shpjeguar mësuesi i letërsisë në maturë. Pas atij shpjegimi ajo pati frikë ta lexonte atë libër, por erdhi dita që ta përjetojë vetë, në shpirt e në zemër, në sytë e tmerruar të Bekimit dhe në pasigurinë për jetën e djalit. Ishte e bindur se nuk do ta lejonin më të takonte të shoqin. Por çuditërisht, pa kaluar një muaj, një postier i solli një zarf në shtëpi. E hapi me drithërimë dhe sa nuk i pushoi zemra, kur lexoi se pas dy ditësh lejohej të shkonte në burg për të takuar të shoqin. Iu ftoh i gjithë trupi nga një ndjesi e keqe; dimrin e ndiejnë këmbët e pleqve, duart e fëmijëve dhe zemrat e grave.

Përgatiti me ngut rroba dhe ushqime, e çoi djalin te një shoqe dhe mori përsëri rrugën e ferrit e të fajit të saj, krejt ndryshe nga ajo e Dantes. “Ai shikonte të tjerët duke vuajtur ferrin, ndërsa unë e vuaj vetë”, mendoi gjatë gjithë rrugës. Apo nuk hasi edhe në një shofer *skode* që transportonte mineralin e burgut, i



cili, gjatë gjithë rrugës, e shikonte si maçoku copën e sallamit dhe në fund e pyeti: “të të pres për kthim?”. Ajo u tremb nga ato fjalë, por ngriu si hejt e akullit, kur zbriti dhe, në sheshin përpara ndërtesave të burgut, pa makinën me ngjyrë jeshile të errët (“si ajo trikoja e gjendjes civile ditën që vdiq Diktatori”, mendoi). Iu morën mendtë dhe numrat e targës së makinës i vranë sytë, vijëzat e tyre të zeza u bashkuan dhe asaj iu dukën si gryka armësh.

Kur mbaroi takimi, Bekimin e nisën menjëherë për në galeri, ndërsa Azizen e mbajtën dhe, pas pak, e çuan në një zyrë të ndërtesës trekatëshe. Aty ishin zyrat e komandës së burgut, me sa kuptoi Zizja, kur lexoi fjalën “Komandanti” në derën e zyrës ku e futën. E priste një tmerr i pamenduar. “Aty m’u përmbys bota për herë të dytë!”, i tha doktoreshë Borës, kur i tregoi jetën e vet, jetëzezën e Zizes. Në krye të zyrës, me kokën ngritur përpjetë, si gjarpri në pritje të viktimës, ai, Zenun Vëngu. “Shoku Zeno, po iu lë të mbaroni punë”, tha komandanti i burgut dhe u largua. Azizja pa shpatullat e tij të rënduara paksa përpara dhe iu duk si një buall, që vrapon i trembur nga gjarpri. “Dhe unë jam trishtili në gojën e këtij zvarraniku të helmtë”, mendoi dhe ndjeu gjakun t’i largohej nga trupi, të rridhte poshtë, poshtë, te këmbët, në fund të këmbëve, në tokën e thatë... dëgjonte vetëm kërcitjen e kupave të gjunjëve që përplaseshin e ajo nuk kishte pikë fuqie për ta ndaluar atë dridhje.

“E njohe targën e makinës?”, u shkrehën grykat e numrave. Të gjitha mbi trupin njomëzak të djalit të

saj, që akoma nuk e kishte bërë një vit jetë. Copëzat e trupit të njomë u hapën tishka-tishka në të katër cepat e asaj dhome të ferrtë. “Të parën herë më vranë me një plumb, sot me katër”, mendoi Azize Murga dhe kuptoi se, tashmë, nuk kishte mbetur asgjë nga jeta e saj, asgjë nga trupi i saj, as dy kupa gjunjësh dhe as dy dritëza syri, as dy pika shpirti, asgjë... asgjë...

Pas dy muajsh e lajmëruan të shkonte në burg për të marrë sendet personale të burrit. E çfarë të merrte? Rrobat e tij ishin bërë leckë sikur t’i kishin ngrënë qentë. Jo qentë, por breshëritë e kallashnikovit. Por edhe gurët e mineralit nën të cilët ishte përpjekur të fshihej për t’u arratisur.

E kishte menduar një mijë herë. E dinte mirë se ishte e pamundur të kapërcehej rrethimi i burgut. Dy të burgosur që ishin përpjekur më parë, kishin mbetur të mbërthyer nga rryma elektrike që kalonte nëpër gardhin metalik të burgut. Më pas, rojat u kishin lëshuar edhe nga një breshëri plumbash, si për t’u siguruar se nuk mund të lëviznin më. Nga galeria nuk mund të largoheshë dot, se ruhej në çdo hyrje dhe dalje. Mund të fshiheshë diku, në ndonjë gaverrnë, por ajo do të bëhej shpejt varri i çdo guximtari, që do të vdiste nga uria dhe mungesa e ajrimit. “Tremozha është e vetmja mundësi”, kishte menduar Bekim Murga. “Edhe sikur të vdes, të paktën nuk do të më mendojë pendesa pse nuk u përpoqa, më mirë një vdekje një herë se mijëra të përditshme.” “Edhe jeta,

edhe vdekja duhen meritue”, i kishte thënë njëri nga të burgosurit, për të cilin thoshin se ishte poet. Dhe Bekimi e ëndërronte shpesh veten në bibliotekën e tij të madhe, duke pirë një gotë raki dhe një kafe bashkë me poetin, duke shfletuar edhe librin e poezive të tij. “Ku i mban poezitë, si mundet t’i fshehë nga kontrollorët e përditshëm?” Njëherë u nguc ta pyeste, por pastaj ndërroi mendje. Është pyetje e rrezikshme, vetëm spiunët mund t’i bëjnë këso pyetjesh. “Fletoret e tij i fshihte i vëllai, në rrënjët e një molle”, i tha Zizja Borjanës.

Sa herë që shkarkonte vagonin me mineral mbi hinkën e stërmadhe të tremozhës, me sy e me mendje maste grykën e saj. “Po sikur të bllokohem aty? Do të mbetem kokëposhtë e bythëpërpjetë, të më vrasin për turp!” Një ditë vuri në vagon një gur të madh sa dy koka njeriu, dhe e provoi nëse e zinte gryka e tremozhës. Guri u rrokullis dhe ra në karrocerinë e skodës pa pengesë.

U nis të takohej me lirinë një pasdite vonë, kur ishte në turnin e dytë. Vagonin e ngarkoi me copëra minerali sa më të imta. Dhe priti që edhe poeti ta mbushte vagonin e tij.

- Pse po më pret? - e pyeti ai.
- Vetëm ty të besoj, - i tha Bekimi.
- Ke ndonjë mendje?
- Jo vetëm jeta dhe vdekja, por edhe liria duhet meritue.
- Shko përpara, - i tha poeti.

Kur i afruan vagonët pranë tremozhës, të cilës poeti ia kishte mbrapshtuar emrin duke e quajtur *tmerrozhtë*, ndalën pak dhe bënë sikur kontrollonin rrotat e vagonit. Kur u siguruan se rreth e përtej nuk do t'i shikonte njeri, Bekimi u lëshua me kokën përpara dhe ra mbi mineralin e tremozhës. Poeti lëshoi mbi të mineralin e dy vagonëve dhe kur u siguria se ai qe mbuluar i tëri, i thirri shoferit të skodës që e priste nën grykën e tremozhës.

“Gati. Shkarkim!”, dhe iu duk sikur thirri: “Gati. Lirim!”. Bëri sikur po ndizte një cigare dhe qëndroi derisa minerali u shkarkua mbi kamion dhe shoferi e ndezi për ta nisur. Duke parë skodën që largohej, poeti i burgosur vuri re se dielli ishte në perëndim dhe pyjet përtej kampit të burgut kishin marrë një ngjyrë të kaltër. Ajo ngjyrë do t'i përshfaqej në sy edhe tre vjet më vonë, kur do ta varnin në qytetin e tij verior. Por atë ditë ishte i lumtur; kishte ndihmuar një “dashnor të lirisë”, siç do ta quante në një poezi të vetën, për ta kërkuar, qoftë edhe me jetë, dashurinë e tij. Kur u nis kamioni i ngarkuar me mineral dhe me trupin e një njeriu nën të, poeti shtyu dy vagonët drejt galerisë. Në mendjen e tij përsëriste, për të mos i harruar kurrë, vargjet e një poezie që po i buftonte në shpirt.

Pa kaluar një orë, në kamp dhe përreth u dëgjuan krisma armësh dhe të lehura të egra qensh. Të burgosurit u kruspullosën nëpër dhoma.

“Asnjë të mos dalë përjashta! As në dritare!”

Të gjithë hamendësonin për çka po ndodhte, por askush nuk mund t'u besonte, jo vetëm të tjerëve,

por as vetvetes. Shumë shpejt i sollën në kamp edhe të burgosurit e turnit të dytë dhe, bashkë me gjithë të tjerët, i rreshtuan në oborr. Pas shpinës së tyre nxinin grykat e *tmerrozhës*, si armë të përmbysura. Menjëherë pas thirrjes së emrave, të gjithë e morën vesh se mungonte vetëm njëri prej tyre: Bekim Murga.

Papritur, sikur të mbinte nga dheu i zi apo nga nënthemelet e ngrehinave të burgut, para të burgosurve doli Zenun Vëngu. Ai urdhëroi të kontrollohen të gjitha “vrinat” nëpër galeri dhe dhomat e të burgosurve, çdo kaçube pylli dhe... poetit sa nuk i pushoi zemra, kur dëgjoi urdhrin:

- Ndaloni të gjithë kamionët e ngarkuar me bakër!  
Asnjë të mos e kapërcejë urën!

“Bakri çan bllokadën, por nuk e çan dot robërinë”, mendoi trishtueshëm poeti dhe ndjeu se si po i vdisnin brenda vetes të gjitha vargjet e menduara asaj dite.

Mesnata ishte e kujëshme. Ejkatat e pyllit dhe cikamat e qenve të burgut dukej sikur kërcënonin edhe yjet e rralla të qiellit. Të gjitha dritat e burgut ishin fikur dhe errësira u ishte përbiruar të burgosurve deri në pikën e fundit të gjakut. Trutë u ishin mpirë dhe ndonjë fije shprese, sapo ndizej edhe fikej. Por u shuan përfundimisht, kur u dëgjua një breshëri e egër dhe kërcënuese. Qëlllohej shumë afër. Papritur u ndezën të gjitha dritat e burgut dhe u dha urdhri që të burgosurit të dilnin përjashta menjëherë. Dolën, ca të veshur e ca të zhveshur, ashtu si i gjeti urdhri për të dalë nga dhomat. I rreshtuan përsëri përpara

tremozhave dhe u ndezën prozhektorët e kullave të vrojtimit. Nga një makinë që frenoi me tërsëllëmë përpara këmbëve të të burgosurve, hodhën një trup njeriu, të cilin ishte e vështirë ta njihje, ishte copëtuar nga plumbat.

Por gjithë të burgosurit e dinin se ai ishte Bekim Murga, nuk mund të ishte askush tjetër. Zenun Vëngu nxori revolverin nga këllëfi dhe qëlloi edhe dy herë të tjera dhe, me një urrejtje e përbuzje të tejbotëshme, tha:

“Tani nuk mungon asnjë!”.

Pastaj i dha urdhër komandantit të burgut që të mbaheshin aty të gjithë të burgosurit, deri në mëngjes.

“As kufomën mos e hiqni! Ta shikojnë dhe të ngopen!”

\*\*\*

Azizja nuk pranoi të merrte leckurinat e përgjakura të burrit të saj. Tmerrohej kur shikonte gjakun e pastër të Bekimit, të përzier me ndyrësirat e burgut. Mori vetëm orën e dorës, të markës *Shanghai*, e vetmja që asokohe shitej në gjithë Shqipërinë. Ia pat blerë vetë ajo, kur Bekimi mbushi njëzetvjetorin e lindjes dhe ishte e para herë që ai vinte orë në dorë. Edhe e fundit. “Do ta ruaj për djalin”, mendoi ajo në atë grimë kohë dhe sikur iu zbut dhimbja. Por ajo pak që mbeti, therte ashpër në fundin e zemrës. Kur u nis të largohej nga oborri i burgut, një trumbë të burgosurish e shikonin

në heshtje, një heshtje e përzishme sikur secili prej tyre të shikonte vdekjen e vet. Në një imtë ajo ktheu kokën dhe u hodhi vështrimin më të trishtë të botës, si bijë e asaj kohe vrastare, si motër e atyre të vdekurve që po e përcillnin në heshtje dhe si nënë e një djali të mbetur jetim.

“Liria nuk vdes kurrë!” Ishte një zë që i ngjau si ai i Bekimit të saj, por ktheu kokën rrëmbimthi dhe kuptoi se ajo britmë kishte fluturuar si zog nga ai grumbull njerëzish, që Azizes iu dukën si trungje të thara pylli. Të thara në këmbë. Poeti thirri edhe një herë: “Liria nuk vritet!”.

Pas shumë kohësh do ta merrte vesh se ajo britmë lirie doli nga gjoksi i poetit Havzi Nela, që do të varej tre vjet më vonë.



I dha Zizes një qetësues, por dy orë më vonë, në Lshtëpi, mendoi se do të ishte mirë të merrte edhe një për vete. Megjithatë nuk e piu me mendimin se truri i lodhur, më në fund, do t'i shuante të gjitha pejzat dhe do të pushonte. Kaloi ashtu edhe një orë tjetër, duke kapërcyer në mendjen e vet nga një gërbellë në tjetrën. Ishte ftohtë dhe kishte shumë baltë. I përshfaqeshin grindjet në mbledhjet e organizuara pas dy vdekjeve të jashtëzakonshme në pavijonin e saj... Pakujdesi e palejueshme... nënvlerësim i faktorëve të sëmundjes... mospërfillje e përvojave të kolegëve të tjerë, të huaj dhe të vendit. Të gjitha këto kulmuan me atë çfarë tha drejtori, në mbështetje të diskutimit të një kolegu specializant, duke e quajtur “puro mendjemadhësi profesionale dhe më gjerë.” Ajo nuk u ktheu asnjë përgjigje, sepse ishte e bindur që nga të gjitha sa u thanë, asgjë nuk ishte e vërtetë dhe, për më tepër, i dukej si kotni. Ndiante dhimbje të zemëruar. Dhe ato dy orë që kaloi ulur në cepin e krevatit të Azize Murgës e bindën edhe më shumë. Të gjithë e konsideronin një sëmundje enigmatike atë *covid* të

mallkuar, të cilit, nuk dihej se kush, as pse, i kishin vënë atë numër, 1984, që të kujtonte titullin e një romani të famshëm të Oruellit. Dhe asaj po i ndodhte pikërisht ashtu, me ndryshimin që të gjithë i qenë turrur të bënë rolin e Vëllait të Madh, madje edhe ai specializanti i përkëdhelur nga drejtori i spitalit.

Borjana Damatin nuk e shqetësonin shumë fjalët që thuheshin për të dhe për të vetëvrapurët e saj. As fakti i njohur botërisht se akoma nuk dihej natyra dhe origjina e virusit, a kishte prejardhje nga shpendët, nga lakuriqët e natës, nga karkalecat, nga minjtë, gjarpërinjtë apo ishte prodhim makabër në laboratorët e studimeve ushtarake, siç thoshte Bernard Bimo, aktori i dështuar që ishte bërë mjek. E shqetësonin pasojat, jo vetëm të vetë sëmundjes, por edhe të medikamenteve që përdroreshin. Në disa telefonata me disa kolegë gjermanë dhe italianë, që i kishte njohur gjatë specializimeve të kryera në vendet e tyre, kishte dëgjuar disa teza që hulumtonin në ruajtjen apo prishjen e raporteve mes ARN-së dhe ADN-së, të cilat mund të kishin pasoja të panjohura deri në atë kohë, sidomos pasoja mendore. Por Bimo përpiquej ta qetësonte se e gjithë ajo katrahurë që po i ndodhte botës, ishte vepër e mafias farmaceutike, që e kishte futur në kurth jo vetëm atë, Borjanën, por gjithë njerëzimin. “Është një trini e mallkuar”, thoshte ai, “mafia, shteti dhe virusi, është vështirë të përballësh njëherësh me të tria kuçedrat! Mos lejo të të mbysë zymtimi i pashkak!”, kishte deklamuar ai, më në fund,

dhe ishte larguar duke folur me vete. “Me siguri”, mendoi Borjana, “po pëshpërit *Poemën e mjerimit*, atë me të cilën konkurroi për t’u pranuar në Institutin e Artit Dramatik, ku, për çudi, nuk e pranuan.” Kohët e fundit kishte filluar që fjalën *mjerim*, në poezinë e Migjenit, ta zëvendësonte me fjalën e ditës, *Covid*...

*Kafshatë që s’kapërdihet asht, o vlla Covidi,  
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të zë trishtimi  
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta  
që të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita  
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
të tanë jetën e vet derisa të vdesin...*

“Ky *covid* është mjerimi i njerëzimit”, i kishte thënë një ditë Borjanës. Dhe kur u vetëvra i sëmuri i dytë, ai u afrua pranë saj dhe, me një zë vajtimtar e ngushëllues, i pëshpëriti:

*Covidi s’ka gëzim, por ka vetëm dhimba,  
Dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh,  
Që t’apin litarin të shkojsh fill’e të varesh...*

Kur i mori vesh drejtori këto *recitime covidiane*, e thirri dhe e paralajmëroi për “pushim nga puna, si përhapës i pesimizmit”. Që nga ajo ditë ai nuk i recitonte, por i pëshpëriste me vete ato vargje.

Borjana po përpiqej t’i bashkonte mendimet, argumentet, ndodhitë me të sëmurët e saj, për të kuptuar sadopak se çfarë po ndodhte, cilat qendra të trurit nxiteshin nga virusi apo nga medikamentet dhe vaksinat që synonin të ndalonin përparimin e sëmundjes së tmerrshme, me rekorde vdekjesh dhe

lemerisje të njerëzve në gjithë botën. I vinte në mendje, për të disatën herë, zëri i presidentit të ri amerikan, njëherësh i trishtë dhe qetësues, që krahasonte numrin e vdekjeve nga sëmundja me atë të të vrarëve nga dy luftëra botërore. Mirë vdekjet se me ato po mësohej bota e shkretë, që tashmë rrotullohej jo mbi boshtin e saj kozmik, por mbi diametrin e vogël të një shishke me vaksinë, por ç'mund të thuhej për vetëvrasjet e të sëmurëve? Dhe dy të parat i ndodhën asaj, pikërisht asaj, që disa çapaçulë të pëshpëritnin të ngazëllyer: iu thye qypi edhe Borjana Grenzës! I shkaktonte një dhimbje të brendshme, të panjohur më parë, ky gëzim i të tjerëve që vinte nga vdekja. Dhe, nga kush? Nga ata që recitonin përditshëm dhe jargavitshëm betimin e Hipokratit.

Çfarë i shkaktonte vetëvrasjet? Pyeti një mijë herë veten dhe një mijë herë nuk e gjente dot përgjigjen. I vetëvrari i parë ishte një rast i panjohur, një rast i humbur, për të cilin nuk u interesua asnjë familjar, ndërsa i dyti kishte diçka që dilte përtej virusit, përtej vaksinave, përtej kurave spitalore. Ose të paktën këtë kishte dashur t'i thoshte e shoqja, duke i sjellë fletoren e tij të shënimeve. Ka ndier ndonjë pendesë të madhe ndoshta, pendesë të cilën ankthi i sëmundjes ia ka përndezur edhe më tepër. Kërkoje atje ku nuk shihet dhe nuk mendohet, iu kujtua këshilla e virologut më të njohur të vendit, i vetmi ndër të gjallët që kishte studiuar në Institutin *Pasteur* të Parisit.

Rikujtoi bisedën e fundit me të. U habit, madje ndjeu dhimbje, kur mendoi se mos profesori i kishte filluar skleroza. Ai nuk i foli aspak për të rejat shkencore të virologjisë, por për disa lule dhe barishte që kishin lidhje me psikozat njerëzore. Nuk i kishte mësuar nga mjekërbardhët e Parisit, por nga një plakë e rrudhur e një fshati në fund të skajbotës, ku e patën dërguar të zbulonte një sëmundje, për të cilën, edhe atëherë thuhej se mund të kishte ardhur nga lakuriqët e natës, apo nga dhelprat e kuqe. Por profesori zbuloi se sëmundja shkaktohej nga ndalimi i dashurisë së të rinjve të fshatit, prej ushtarëve që ruanin kufirin e shtetit, dhe, po për këtë arsye, ndalonin edhe daljen e djemve në dritaret e vajzave, për të folur e për t'u përkëdhelur me to.

Atëherë ai kishte dëgjuar për herë të parë për një lloj bari që quhej *strashec*, të cilin plaka e Bukojnës e përdorte për fëmijët e frikësuar. Vetë fjala *strashec*, në gjuhën e plakës do të thoshte bari i frikës, ajo e mblidhte dhe e thante e, kur fëmijët trembeshin natën, u bënte një çaj me atë bar të magjishëm, që i qetësonte. “Frikën e fëmijëve e zhduk, por të burrave jo”, thoshte atëherë plaka. “Frika nga shteti, nga ushtari, nga komandanti, nga kryetari, nga lufta e klasave ishte më e madhe nga frika e lugatit.” Borjana Damati nuk e kujtonte mirë se kush i kishte thënë ato fjalë, plaka apo profesori. Ndoshta profesori, i cili bëri disa vite internim vetëm e vetëm pse tha një të vërtetë, të cilën shumë të tjerë patën frikë ta shqiptonin. Ajo kujtoi

fjalët e njërit prej të vetëvrrarëve të saj: “Jetuam me frikë dhe tani jetojmë me turpin pse patëm frikë!”.

Por ajo frikë nuk ishte zhdukur. Zizja e shkretë kishte akoma frikë nga fishkëllima e gjarprit nëpër buzët e Zeno Vëngut. Do të duheshin plantacione të tëra me barin e plakës nga Bukojna, asaj plakës së fundbotës, që të zhdukeshin të gjitha frikërat e njerëzve. Ndoshta ajo plakë, tashmë ka vdekur dhe s’ka mbetur njeri ta njohë atë barin e frikës, për të bërë çaj për gjithë botën. Borjana ndjeu një hidhnmim të beftë.

“Kishte trininë e vet ajo plakë”, dëgjonte zërin e profesorit. “Të gjithë ne kemi trininë e shenjtë, ati, biri dhe shpirti. Ajo kishte diçka tjetër: *strashec*, *stramec* dhe *stratorec*. I pari ishte bari kundër frikës, i dyti ishte lule kundër turpit dhe i treti lule kundër çdo të keqeje që e kërcënon njeriun. I pari bëhej çaj dhe pihej. I dyti bëhej tufë dhe thahej i varur në murin e dhomës së gjumit. I treti, gonxhet e të cilit i ngjanin lafshës së gjelit, përdorej për të spërkatur njerëzit, që të mbroheshin nga lugati dhe çdo e keqe tjetër.

“Ta dish nga unë, Bora; askush në këtë botë nuk është i lirë nga frika, nga turpi, as nga e keqja.”

“Ah, profesor, profesor”, mendoi Bora, “ç’janë vallë këto teori?! Ndoshta ka diçka të vërtetë në këto përsiatje të fundme të profesor Rekës, apo është thjesht kënga e fundit e mjellmës?” U ngrit dhe piu një qetësues se nuk po i përballonte dot të gjitha ndërdyshjet që e kishin kapluar. Qetësuesi bëri

punën e vet dhe ajo filloi të largohej nga zëri i lodhur i profesorit... harroi barin e frikës... harroi spërkatjen me ujin e *stratorecit*... por ai emri i tretë iu ngul turjelë në tru: *stramec*, lulja e turpit... ah, kjo po! Edhe kur zhduket frika dhe çdo e keqe tjetër, na mbetet turpi, na mbetet ajo që duhet ta harrojmë, por nuk e harrojmë dot. Turpi ta kalb zemrën.

“Ah, çfarë bëre, Zize, moj e zezë!”

“Ku e ke burrin, ku e ke djalin, moj shkretazizë?!”

U ngrit dhe kërkoi fletoren e shënimeve të Fitim Zagorës.

\*\*\*

U vërtit nëpër kthinat e shtëpisë, por fletoren nuk e gjeti. Mendoj se mos e kishte lënë në spital, në dhomën e mjekëve ku, siç i vinte ndër mend, kishte lexuar pjesë të atyre shënimeve gati-gati halucinante, ku përziheshin krenaria idiote e nëpunësit tipik të kohëve të diktaturës me ca dromca pendese, edhe ato jo të nxitura nga brerja e vërtetë e ndërgegjes, por nga ndonjë prishje e ekuilibrit mes ARN-së dhe ADN-së, siç kishte filluar të hamendësonte doktoreshë Borjana Damati. Nga ato pak shënime që kishte lexuar, kuptoi se i vetërvrari i saj ishte një nga ata mijëra nëpunës gjithfarësh që kishin jetuar me besnikëri qeni, me entuziazëm laraske dhe frikë lepuri, të mësuar për vite e vite që duhej të mendonin diçka, por të thoshin tjetër gjë. Kërkoi edhe në bibliotekë, jo vetëm mbi tavolinë

apo mes librave më të njohur të saj, por edhe në ca vende, ku ishte e sigurt, se kurrë nuk do t'i shkonte në mend të linte atë fletore. Përmbysi të gjithë jastëkët e divaneve në kuzhinë, madje, e inatosur me vetveten jo pse nuk po e gjente atë fletore, por pse po e kërkonte akoma, lëvizi edhe mbështetëset se mos e gjente aty. “E kush do ta ketë futur këtu? Po mendoj se mos ka ardhur djalli dhe ma ka fshehur atë fletore?” I erdhi keq për veten, kur kuptoi se sa ishte lodhur mendërisht ato ditë, pas vetëvrasjes së dy pacientëve të pavijonit të saj. Piu një gllënjë lëng pjeshke nga ai që mbante në frigorifer, më i parapëlqyeri i saj ngaqë prodhohej në Gjermani dhe firma *Pfanner* e lëngut i kujtonte njëherën nga vaksinat kundër *Covid-1984*, që ishte nga të parat e prodhuara në botë. *Pfaner... Pfaizermaner...* bërbëlitë ajo, duke u tallur me veten. Ashtu i ndodhte shpesh në ditë krizash profesionale... keqardhje për veten, më pas tallje dhe ironi me veten dhe, më në fund, inatosje kundër vetes, ndjesi që e lodhte edhe më shumë shpirtërisht.

U kthye në dhomën e gjumit për t'u shtrirë, me një shpresë të mjegulluar se mos e zinte gjumi i pragditës. Hapi dritën e komodinës për të parë orën dhe... hej drej! Fletorja ishte aty. E kapi me inat dhe e përplasi në poshtështrojë, por më pas u qetësua dhe e rimori për ta lexuar. Nuk kishte shumë durim dhe nisi t'i kapërcente fletët me një vështtrim rrëshqitës, duke kapur copëza frazash dhe fjalësh që i tërhiqnin vëmendjen. Ndjeu një rrymë tronditëse,



por të parrezikshme, si ajo kur rrobat me fije sintetike ngarkohen me elektricitet, që të trembin një imtë, kur i prek... Syri i kapi fjalën vetëvrasje... dreq o punë! Edhe këtu vetëvrasje? Edhe në atë kohë?

Fitim Zagora shkruante për vetëvrasjen e një aktori të njohur në ditët e xhirimit të një filmi që, për dreq apo për rastësi, titullohej “Vjeshta e fundit”, dhe kishte qenë dita e fundit e aktorit. Ishte hedhur nga kati i tretë ose i katërt, në hapësirën e shkallëve të hotelit, në të cilin kishin qëndruar aktorët, regjisorët, operatorët dhe realizues të tjerë të filmit. Doktoreshë Borjana Damati u habit, kur në shënimet e Zagorës lexoi frazën: *E prisja këtë ngjarje tragjike*. “E përse e prishte këtë vetëvrasje ky kopuk?” Ajo pa tashmë te vetvetja një idhnake të trazuar shpirtërisht; e gjithë bota i dukej fajtores për çka kishte ndodhur, për çka asaj i kishte ndodhur me dy të sëmurë, njëri anonim i panjohur dhe tjetri “anonim shumë i njohur”, për sa kohë që çdo mëngjes takohej me diktatorin dhe i lexonte lajmet e ditës.

U kthye disa faqe më përpara për të gjetur ndonjë të re, ndonjë detaj që nuk e dinte për vetëvrasjen e aktorit. Edhe ajo e mbante mend ceremoninë e varrimit. Kishin shkuar shumë njerëz, disa autoritete, gazetarë, admirues të aktorit; shkruan disa gazeta, u dhanë lajme në radio dhe televizionin e vetëm të vendit, por asgjëkund nuk u dëgjua fjala vetëvrasje. Të gjithë mendonin se aktori kishte vdekur nga një goditje e papritur cerebrale apo nga pushimi i zemrës,

madje për ta heroizuar, gazetat kishin shkruar se tragjedia ndodhi gjatë xhirimeve, edhe pse ishin të shumtë ata që e dinin se ngjarja kishte ndodhur herët në mëngjes.

Diku, syri i kapi frazën se aktori banonte në të njëjtën shkallë me Fitim Zagorën dhe ndoshta ai i kishte shkruar ato fjalë thjesht si një kujtim për fqinjin e vet, por disa faqe më tutje gjeti disa fraza, që e detyruan të ndalej. Ai tregonte, me një keqardhje që nuk e fshihte, se një mëngjes duke i lexuar lajmet diktatorit, me shumë entuziazëm ishte ndalur te filmi i fundit i shfaqur ato ditë në kinematë e kryeqytetit. Kritika e lavdëronte shumë rolin e realizuar prej aktorit, duke nënvizuar që ai kishte sjellë në ekran një komisar jetësor dhe aspak skematik, si në filma të mëparshëm. Ai e donte shumë atë aktor jo vetëm se ishte nga më të talentuarit e vendit, por edhe ngase e njihnte dhe kishin një miqësi të lehtë, siç ndodh zakonisht me fqinjët. Prandaj po i lexonte ato lajme me shumë dëshirë, me më shumë detaje nga raste të tjera të lajmeve të kulturës dhe ndjeu se “një sëpatë i ra pas qafe” (pikërisht ashtu kishte shkruar Zagora) kur dëgjoi diktatorin që shkumëzonte nga inati.

*“Komisar?! Ai luan rolin e komisarit? Ç’është ky bataqçillëk në kinematë tona! Vëllai i një spiuni revizionist luajta rolin e komisarit? Të ndalohet filmi! Të ndalohet menjëherë!”*

*Nuk e kisha parë kurrë të shkumëzonte nga inati si atë ditë, shkruante Fitim Zagora dhe pastaj tregonte se*

urdhri u zbatua menjëherë, filmi u ndalua, por pastaj, dy-tre muaj më vonë, ai pa në reklamën e kinemave lajmërimet për rishfaqjen e filmit. Kur u kthye në shtëpi, në hyrje të shkallës u takua me aktorin dhe me gëzim të madh i tha: *“Filmi yt po shfaqet përsëri”*. *“Shko shikoje, shko”*, i tha aktori, pa shfaqur kënaqësi, përkundrazi e tundi dorën në një mënyrë të pakuptueshme, dyshuese. *Shkoi ta shikonte filmin, por fqinjën e tij, aktorin e madh, nuk e pa gjëkund. Të gjitha skenat e komisarit ishin rixhiruar me një aktor tjetër, i cili, krahasuar me aktorin e shquar, ngjante si sfungjeri me barin e bjeshkës, ose si galloshja mbi këpucë.*

*Që nga ajo ditë ai iu shmang të gjitha takimeve me aktorin; i vinte turp t’i dilte përpara, i dukej vetja fajtor që në rrënimin e tij shpirtëror kishte pasur edhe ai rolin e vet. Ndoshta, po të mos ia lexonte ato lajme diktatorit, gjithçka do të kishte kaluar normalisht, pa zhurmë e bubullima, pa rrufe dhe shkumëzime. Megjithatë, aktorin nuk e mërzi roli i hequr i komisarit, as edhe urdhri që ai, megjithëse aktor i madh, do të vazhdonte të luante përsëri, por në role dytësore, ose në ato të personazheve negative. Ajo që e roniti shpirtin e tij dhe e bëri kalli bosh, ishte heqja e rolit të Hamletit në teatër, të cilin kishte tre vjet që po e përgatiste dhe gjithë jetën që e ëndërronte. “Më vrave, Laert, më vrave!”, thirri ai, kur ia kumtuan lajmin më tronditës që kishte dëgjuar.*

Të gjitha këto, Zagora i shkruante me trishtim, por doktoreshë Borjana nuk gjeti ndonjë arsye për pendesa të mëdha vetëvrasëse. “Ndoshta ka diçka më tutje”, mendoi, por nuk vazhdoi leximin, fiku dritën dhe fjeti një copë herë. Kur u zgjua e ndjeu veten më mirë, kujtoi fjalët e profesor Rekës se të gjitha reaksionet biokimike të gjumit zgjasin jo më shumë se njëzet minuta, ajo është koha çlodhëse e trurit. Gjithë pjesa tjetër është vetëm inerci. I pëlqente shumë ato sentenca të profesorit; më e mira ndër to ishte ajo për ekuilibrin e natyrës, për të cilin, pas një shtjellimi të gjatë të krijimit të atij ekuilibri, shtonte: “Por natyra e vrau veten duke krijuar njeriun, ai e prishi ekuilibrin e saj dhe do ta çojë drejt fundit”.

Edhe një lajm tjetër i mëngjesit i kujtoi doktoreshë Borës prishjen e atij ekuilibri; të gjitha emisionet mëngjesore të lajmeve treguan për një viktimë tjetër, për një të sëmurë tjetër që u vetëvra dy orë më përpara. Nuk ishte nga pavijoni i Borjanës dhe ajo ndjeu një lehtësim, por, një grimëherë më vonë shau veten për atë ndjesi që vinte në përparësi qetësinë e vet, përkundraill jetës së një njeriu. “Ky mut virusi po na ndryshon jetën. Ndoshta nuk kemi rrjedhur, por ama, po pikojmë të gjithë, nga pak dhe përditë.” Bëri dush dhe u nis për në punë.

Kur ndodhi vetëvrasja e tretë në pavijonin e saj, nuk ishte e nevojshme që të tjerët t'i drejtonin gishtin dhe ta akuzonin si fajtorë. Ajo pati një luftë të ashpër brenda vetes dhe, në vend që të tjerët të thërrisnin ti... ti... ti, gjithë trupi i saj, koka që i dhembte tmerrësisht, duart që i dridheshin, këmbët që nuk i urdhëronte dot të shkonin atje ku e prisnin, një gjyle e rëndë në stomak dhe fryma që i merrej heraherës, bërtisnin dhe këlthisnin madje... unë... unë... unë... Unë e kam fajin. Unë dhe askush tjetër!

Ndërkohë që merrej me Azizen, nuk ia vuri mendjen përkthyesit Petro Murra, që një mesnatë e thirri për të parë atë grua të mjerë që mund të vriste veten. Ai i kishte thënë që pa disa lëvizje të dyshimta të Azizes në gjysmëterrën e korridorit të spitalit. I tregoi se kjo gjendje i ishte shfaqur pas shtrimit, në pavijonin e tyre, të Zenun Vëngut. Të nesërmen i kishte lexuar një skicë apo ese të shkurtër të një shkrintari kolumbian, Mario Lamo Jimenez, që fillonte me një frazë të lemerishme: *Kam shtatëmbëdhjetë orë që kam vdekur dhe ende nuk po më varrosin...*

- Ti e ke përkthyer? - e pyeti Petron.

- Jo, një përkthyes tjetër i spanjishtes, shumë i talentuar.

- E pse po ma jep mua?

- Nuk jeni kureshtarë, dokoreshë Bora, që ta dini se çfarë mendon një i vdekur? Varri nuk ka derë, por njeriu ia hap vetes...

Pak nga kureshtja dhe pak për të mos u dukur e paimterësuar për çka po i ofronte i sëmuri i saj, e dëgjoi deri në fund...

*Kam shtatëmbëdhjetë orë që kam vdekur dhe ende nuk po më varrosin. Sa e mërzitshme qenka të jesh i vdekur! Të paktën, po të kisha një puro për ta tymosur, nuk do të mërzitesha kaq shumë duke pritur... Kur mbërrita në spital, tashmë i vdekur, nuk donin të më pranonin, pasi nuk e kisha dokumentin e sigurimeve shëndetësore. Dikush, midis kureshtarëve, më kishte vjedhur portofolin dhe orën e dorës. Ora e dorës nuk më interesonte se s'kishte ç'më duhej më, por humbja e portofolit më dhembti, sepse ishte prej lëkure deveje dhe e kisha kujtim nga Elisa. Në agjencinë e varrimit më provuan gjashtë arkëmorte, por asnjëri nuk më bënte. Ishin të vegjël dhe, më në fund, për të kursyer paratë, ime shoqe vendosi për një që ishte imitim i drurit të moganit, por, meqë as ai nuk më nxinte, më hoqën këpucët dhe m'i përthyen këmbët. Tani do të më varrosin me çorape të grisura...*

- Pse po ma lexon gjithë këtë? - e ndërpreu Borjana.

- Sepse... sepse... unë kam njëzeteshtatë vjet që kam vdekur dhe ende nuk më kanë varrosur, - tha ai dhe u largua.

“Më dha gjithë ato shenja rrënimtare dhe unë, shushka, nuk e vrava mendjen”, shau veten. Dhe filloi t’i fliste e t’i kërkonte llogari vetes. “Kur ai të thirri në mesnatë, si nuk pyete, po ky çfarë ka, çfarë e mundon që vërdalloset dhe e vret natën nëpër korridoret e spitalit? Po të ishte normal do të flinte si të tjerët e nuk do të dilte si somnambul, apo jo? Duhet ta mendoje më thellë, Grenzë, se frika e tij për Azizen nuk ishte gjë tjetër veçse frika për veten, lemeria që i shkaktonin fantazmat e jetës së tij dhe jo të një tjetri. Dhe kulmi, kulmi ishte kur të tha: ‘unë kam njëzet e shtatë vjet që kam vdekur dhe ende nuk më kanë varrosur’. Ajo frazë ishte e llahtarshme! Ishte thirrje për ndihmë e dikujt që ka rënë në gërbellat e jetës së vet, që ka vite që thërret për ndihmë dhe askush nuk e dëgjon. As ti nuk e dëgjove, as ti, Grenza Damati!” I erdhi turp nga vetja. I shkoi në mendje të shkonte, të hiqte bluzën e bardhë, t’ia linte drejtorit mbi tavolinë dhe të ikte, të dilte diku, ku askush nuk e njihte dhe nuk ia dinte emrin, të ikte në botën e grerëzave, të zhdukej larg, shtatëmbëdhjetë vjet larg. “Nuk do t’ia fal vetes kurrë!”, mendoi. Turbull iu ngatërruan nëpër mendje fjalë, germa, paragrafë, të lexuar dikur, në ndonjë libër apo në disa libra, dhe që tregonin se, në disa raste, të sëmurë të tillë, të qetë, të përmirësuar, që hanin dhe buzëqeshnin, që flisnin lirshëm dhe kujdeseshin për

të sëmurë të tjerë, që, madje, bënë edhe humor të lehtë, me një cipë të hollë kënaqësie, pikërisht këta, ishin më të rrezikshëm. “Më saktë, më të rrezikuar”, mendoi Bora. Përmirësimi i tyre ishte kumti se ata kishin zbuluar një shteg për t’i shpëtuar dëshpërimit dhe ky ishte shtegu i vdekjes. “Dhe unë, shushka, nuk e lexova dot atë kumt”, shau veten përsëri.

Për atë vetëvrasje nuk u bë asnjë mbledhje. Ndoshta dhe u bë, por atë nuk e thirrën. Edhe nga pavijonet e tjera vinin lajme tragjike, numri i të vdekurve ishte shtuar dhe, me sa dukej, askush nuk e vriste mendjen për ata që vetë, me vullnetin e tyre, u jepnin fund vuajtjeve, duke u hedhur nga ballkoni, nga dritaret apo nga parapetet e shkallëve. Ah, jo, nga shkallët jo, kishin vënë rrjeta mbrojtëse, edhe dritareve po u vinin grila, në ballkone kishin vënë rojë 24-orëshe dhe tashmë, për çdo të hedhur nga ballkoni, më shumë llogari u kërkonin rojave sesa mjekëve të pavijonit.

Por llogaridhënia më tronditëse ishte ajo brenda vetes. Kjo po ndodhte edhe me Borjana Damatin dhe në atë grimëherë që u tregua më e ashpër me veten se në çdo rast tjetër, ndjeu një si lëvizje paralele në anrrat e veta, ishte gjaku nëpër deje, ishte lëvizja drejtvizore apo rrethore e nervave, apo ishin dy trena që zhurmonin mbi shinat paralele, ajo nuk e kuptonte dot. Brenda vetes... brenda vetes. Janë një, apo dy njerëz brenda një trupi? Kur po i shfaqej fytyra dhe trupi i përkthyesit, ashtu siç e kishte parë në morg, i shkrepiti një mendje që e hutoi edhe më shumë. “Unë po



pendohem pse nuk e ruajta dot atë nga fantazmat e tij, nga pendesa e tij shumëvjeçare? Njëzet e shtatë vjet i vdekur, një shekull i pavarrosur... Çfarë e ka munduar atë njeri dhe pse vendosi sot, pikërisht në pavijonin tim, vetëm pak ditë pas një telefonate në mesnatë? Kush ua prish ekuilibrin e jetës dhe të natyrës së brendshme këtyre qyqarëve?” Kishte lexuar edhe në njoftimet e spitaleve nëpër botë për vetëvrasje dhe i kishte mbetur në mend vetëvrasja e një mjeku italian, ishte penduar pse nuk kishte shpëtuar dot një vajzë 17-vjeçare. “Sa vjeç ishte Petro përkthyesi?”, pyeti veten dhe mori inat, po ndaj vetes. Kishte lexuar edhe dyshimet se disa nga veprimet anësore të ilaçeve ose vaksinave kundër *Covid-1984* shkaktonin te disa të sëmurë kriza të thella pendese.

Madje, ithtarët e asaj teorie shtyheshin shumë thellë në historitë e njerëzimit dhe një nga shembujt pikantë që përmendej ishte ai i një poeti gjerman, Von Platen, i cili nga një pendesë e madhe kishte shkuar enkas në një lagje kolere, e kishte marrë sëmundjen dhe kishte vdekur. Dhe e gjitha kjo nga pendesa për grindjen e tij me poetin e madh Hajnrih Hajne. Kishte shkruar për të se është krenaria e sinagogave çifute, se talenti i buronte nga sperma e Abrahamit e shumë sharje të tjera. Por hebreu i madh ia kishte kthyer keq e më keq, duke shkruar se poezitë e Von Platenit ishin “pëshpërima pederastësh” të një “gjuetari djemsh” apo të “një burri që kurrë s’ka prekur një grua”.

Sipas hamendjeve, të përhapura në shumë media, kishte shumë lloje pendimesh, pendimi ekzistencialist, që e nguc njeriun të kthejë kokën mbrapsht dhe të ndryshojë atë që ka ndodhur, por që nuk duhej të kishte ngjarë në atë rrjedhë, tashmë torturuese; pendimi poetik, sipas të cilit nuk ia vlen të pendohesh për asgjë, sepse vajtimi i gabimeve të jetës nuk vlen. *Quem facti poenitet, bis miser seu impotents es*, mendoj Bora fjalën latine që do të thoshte se ai që pendohet është dy herë mjeran dhe i pafuqishëm.

Vetëm Zoti nuk pendohet, shkruanin të tjerë, duke zhbiriluar të quajturin pendim biblik.

*Dios no es hombre, para que mienta,*

*Ni hijo de hombre,*

*Para que se arrepienta.*

Këto vargje që thoshin se Zoti nuk është gënjeshtar si njeriu, por as edhe bir njeriu që të pendohet, i recitoi një ditë Petro Përkthyesi, kur temperatura e lartë e kishte hedhur në krahët e pavetëdijes. Ata që e njihnin nga afër e dinin se ai recitonte vargje në spanjisht vetëm kur dehej, por në spital e mori atë zakon edhe kur i ngrihej temperatura. Akoma më keq ndihej kur pranë shtratit të tij kalonin sanitaret që shtynin krevatin e ndonjë të sapovdekuri të dhomës. Atëbotë Petroja fliste fjalë pa kuptim, në të gjitha gjuhët që dinte, dhe nuk ishin pak, por shtatë ose tetë.

Por asgjë nuk ishte e sigurt. Borjana besonte pak në ato që lexonte dhe më shumë në fjalët e profesor Rekës... “kërkojeni aty ku nuk duket... duket...

s' duket..." "Më duket se *pandemia* po na kthehet në *pendimí*", përsiati Bora dhe ndjeu lodhje edhe pse sapo kishte filluar dita e punës. *Pandemi-pendimí... pandemi-pendimí... pendimia...* Atë çift fjalësh e përsëriti shumë herë asaj dite.

Si për të gjetur një hije, apo një oaz në shkretëtirë, për të gjitha ato përsiatje, i dërgoi një mesazh profesor Rekës. Ai iu përgjigj vetëm me një fjali: Është e vështirë të hysh në trurin e njeriut. Por, një orë më vonë, sikur ta kishte kuptuar zhgënjimin e ish-studentes së tij më të mirë, i dërgoi një mesazh të gjatë, me shumë të dhëna shkencore mbi trurin. I tregonte se sa për qind ujë ka masa e trurit, sa oksigjen konsumon në ditë, sa gram peshon truri i njeriut dhe ai i elefantit, sa i grave dhe sa i burrave, madje edhe ç'peshë kishte pasur truri i Turgenjevitet dhe ai i Ajnshtajnit, dy njerëzit me më shumë masë trunore në botë, kur fillon dhe kur mbaron veprimtaria e trurit të njeriut, sa sekonda mund të zgjasë jeta e trurit kur i ndërpritet ushqimi me oksigjen, me çfarë shpejtësie lëvizin impulset nervore që dalin dhe hyjnë në tru, çfarë sasive energjie gjeneron, sa yndyrë dhe kolesterol përmban dhe shumë tregues të tjerë.

Por ajo që e habiti edhe më shumë Borjana Damatin ishin disa fakte të reja shkencore. Në çdo sekondë, në tru zhvillohen 100 000 reaksione kimike dhe përjetohen rreth 70 000 mendime në ditë. "Shtatëdhjetë mijë mendime në ditë! Dhe si mund ta dimë ne se çfarë mendojnë të sëmuret? Si mund t'i hap

unë portat e trurit të Azizes?”, pyeti veten Borjana. Nuk dimë saktësisht as ato që mendojmë vetë, sa dëshira, sa intriga, sa mirësi dhe sa poshtërsi, sa dashuri dhe sa pendesa, sa ëndrra të parealizueshme, kurrë ndonjëherë. Çfarë i përcjellim vetes dhe të tjerëve në ato një mijë impulse që lëshojnë neuronet në çdo sekondë dhe në mijëra kontakte sinaptike që kanë me neuronet e tjera? Truri i njeriut, shkruante ai, mund të realizojë 1016 procese në sekondë, çka e bën atë kompjuterin më të fuqishëm ndër të gjithë të shpikurit deri sot nga njeriu. Dhe e mbyllte mesazhin po me frazën e fillimit: Është e vështirë të hysh në trurin e njeriut.

“Po si t’ia bëj profesor? Si ta kuptoj se çfarë pendese e jetës e hodhi Petron drejt vdekjes?” Papritur u kujtua se një ditë, ai i kishte lexuar diçka nga një libërth që e mbante nën jastëk: Është e mërzitshme jeta pa pendesë. Pse? Qysh? Nga sa po kuptonte doktoreshë Bora, ai, e ndoshta edhe shumë të tjerë, për një mijë e një arsye, jetonin dimensione të ndryshme kohore, hapësira të tjera ndjenjash dhe impulsesh trunore. Të jetë vërtet kështu?

Kjo pyetje e mundoi Borën gjatë gjithë asaj dite dhe në ditët që do të vinin.

Kur Azize Murga e mori vesh që ishte vetëvrarë edhe Petro Përkthyesi, u trondit dhe u tmerrua njëherësh. Ishte i vetmi i sëmurë nga burrat, me të cilin kishte folur, qysh se u takuan një natë në korridor.

- As ty nuk të zë gjumi? - e pyeti ai.

Ajo pohoi me kokë, duke zbuluar edhe një buzëqeshje të trishtuar. Më pas u takuan edhe ditën, ai shkante në dhomën e saj për të takuar një kushërirën e vet, por Azizes i përkëdhelej shpirti, kur vinte re që ai bisedonte më shumë me atë sesa me kushërirën. E ndjeu edhe më pranë, kur, një natë, i tha:

- Po na e djeg shpirtin pendesa për çka bëmë, apo nuk bëmë.

Iu duk njeriu i parë në botë që po lexonte brenda shpirtit të saj. I tregoi pak copëza nga jeta e vet, sidomos pas shtrimit të Zenun Vëngut në pavijonin e tyre.

Dhe ja tani, ai Petro që i jepte pakëz besim dhe ndizte në trurin e saj një flakëz shprese, u kishte fryrë dhunshëm qirinjtë të jetës së vet. Nxitoi për në dhomën e tij. Sanitaret po hiqnin çarçafët e shtratit

dhe ashtu i zhveshur, vetëm me një dyshek ngjyrë bezhë, dukej si cepi më i shkretuar i botës dhe caku i fundit i një jete. Azizja ndjeu trishtimin torturues të asaj pak kohe që i kishte mbetur për ta jetuar.

- Gjetët ndonjë bllok shënimesh këtu? - pyeti njërën nga sanitaret. Petroja i kishte premtuar se një ditë do t'ia jepte për ta lexuar atë pjesë të jetës së tij, për të cilën i kishte folur larg e larg. - Pse nuk ma tregon me gojë, kam shumë dëshirë të të dëgjoj, - i kishte thënë Azizja. Por ajo dëshirë e saj e kishte trembur atë, si njeriu që nuk e merr në dorë dhe as nuk e prek një vazo të mrekullueshme, vetëm nga frika se mos i bie dhe bëhet copë e çikë. Sanitarja johnoi me kokë, dukej që përtonte të fliste. Kur ato u larguan, Azizja ngriti një cep të dyshekut dhe e gjeti bllokun. Lexoi vetëm faqen e parë: *Pendimi im i madh!* Nën atë frazë ishte vënë data e një dite më parë, ndërsa gjithçka tjetër ishte shkruar para njëzet e shtatë vjetësh.

\*\*\*

*Nuk mundem... Nuk mundem të mos shkruaj për atë që më ndodhi në Madrid, në javën e fundit të qëndrimit tim atje. Nuk e di çfarë ishte. Nuk e di çfarë ndodhi. Ra një rrufe në qiell të kthjelltë, apo u ndezën yjet edhe ditën? Apo vetëm një hark ylberi kapërceu nga një kontinent në tjetrin, u nder mbi një oqean të tërë, për të lidhur zemrën time me atë të Palomës,*

*për të ndier pëshpërimën e dy shpirtrave tanë, për të shijuar vesën e trëndafiltë përmes buzëve tona?*

*U takuam pas nëntë vite pritjeje. A e besonim? A e shpresonim këtë ditë? Tani që jam kthyer dhe kam lexuar edhe një herë të gjitha letrat që ajo më ka dërguar deri në vitin 1990, thuajse nuk shihet në to asnjë shenjë dashurie e mirëfilltë, në atë kuptim që na bashkoi në Madrid... Diku tri pika reticence. Diku shprehja na ndau oqeani, vallë a do të shihemi edhe një herë? Por gjithnjë nën harkun e lidhjeve politike, të nisura si të tilla në nëntor 1984. Dhe gjithnjë të nënshkruara nga ajo dhe i shoqi, por të shkruara vetëm nga ajo. Po kështu, madje më të përmbajtura dhe më të trembura, ishin letrat e mia; e dija që çdo letër që nisej nga Shqipëria për jashtë shtetit, hapej, fotografohej, lexohej dhe arkivohej. Por...*

*Unë gjithçka e ndieja në shpirt dhe të shtypur nën vete. Dhe gjithnjë më shfaqej pamja e një tarrace aeroporti ku e pashë për herë të fundit, duke tundur njërën dorë për të më përshëndetur dhe tjetrën te sytë, për të fshirë lotët e ndarjes. Nën peshën e parullave politike ndieja diçka tjetër, ëndërroja, flisja me vete, pëshpëritja. Por, oh, sa larg! Më shumë se 13 mijë kilometra. Në mbrëmjen e fundit që organizuan për delegacionin tonë, kur më kërkuan të flisja edhe unë, thashë plot entuziazëm: midis dy vendeve tona shtrihet një oqean i tërë që na ndan, por kur njerëzit miqësohen, ata i ndan vetëm një lumë i vogël si ky i qytetit tuaj. Por, e dija që po gënjeja veten.*

*Kaluan nëntë vjet dhe thuajse e humba çdo shpresë se ndonjë ditë do ta takoja përsëri. Pak nga pak, nga dita në ditë, ajo dhe lotët e ndarjes në aeroport po merrnin përmasat e një legjende në shpirtin tim. Një mit që nuk ka ekzistuar asnjëherë mbi tokë e nën qiell, por vetëm në ëndërrimet e mia. Dhe, megjithëse qindra herë kam thënë me veten time, pazëshëm apo edhe duke folur, mos vdeksha pa shkuar edhe një herë atje, çdo ditë e më shumë e ndieja pamundësinë e kësaj dëshire. Shqipëria, vend i një galaktike të panjohur për botën dhe izoluar prej saj, siç shkruanin gazetat e Perëndimit, na mbante mbyllur në guaskën e vet. E vetmja mundësi ishte dërgimi i ndonjë delegacioni atje, por kjo gjë ndodhte një herë në disa vjet dhe ne përkthyesit e spanjishtes ishim një duzinë, të gjithë të diplomuar në universitete kineze. Miqtë tanë spanjishtfolës habiteshin sesi mund të mësohej spanjishtja në Kinë dhe na kishin treguar se dikush kishte përkthyer “Don Kishotin” në spanjisht, nisur nga varianti i botuar në kinezçe dhe, si përfundim, kishte dalë një hidalgo, që as vetë Servantesi nuk do ta njihje.*

*Dëshira më digjte dhe kurioziteti më gërvishte përbrenda. Isha në zgrip të pikëpyetjes: vallë ç’ka ndodhur me mua? Vallë ç’ka ndodhur në shpirtin tim? Të kem rënë në dashuri që në takimin e parë? Po me Palomën a ka ndodhur e njëjta gjë? Si mund të ndodhte, kur unë nuk i kisha dhënë asnjë shenjë të atyre gjërave që i mendoja i frikësuar edhe nga vetja,*



*i dyzuar dhe i çapëlyer në mendime dhe përsiatje të çuditshme.*

*Por... më duket se e mposhta qiellin. E mundëm bashkë me Palomën. Deshi Zoti, apo fati? Apo e ngrita fatin e kësaj dashurie me kokrriza rëre për nëntë vjet, të gjata sa një pafundësi. Kushedi sa herë më është derdhur rëra e imtë e kësaj kështjelle ëndrrash, ashtu siç bie në kohëmatësit prej rëre. Kushedi sa herë më ka rrëmbyer uji i shkumëzuar i oqeanit! Valët e tij më kapërthyen edhe mua dhe, pas ngjarjeve të vitit 1989, kur ra dhe muri i Berlinit, për një imtë (oh, sa shumë zgjati!) mendova se gjithçka mori fund, se gjithçka ishte shkumë deti. Dhe ishte e natyrshme. Letrat tona i kushtoheshin vetëm “Shqipërisë socialiste”. Ajo u shua, kështu që do të shuhej edhe ajo miqësi, ajo rreze shprese për diçka të bukur dhe të frikshme në jetën time.*

*Por një telefonatë imja nga Roma, një vit më vonë, dhe pastaj një letër nga Paloma. Ç’ka ndodhur në Shqipëri? Por kryesorja: ti, Pedro, si je? Por përsëri heshtje... Magma e shpirtit ftohej dhe ngrohej, shpërthente dhe përzihej me pluhurin e rrugëve, si vullkani i Piçinçës. Udhëtova kudo, tashmë vinin dhe shkonin plot delegacione, biznesmenë, gazetarë, në Shqipëri dhe Europë, por ata sy, ose më mirë të them, atë vështrim që diçka të panjohur kërkonte tek unë, nuk e gjeta asgjëkund. Çdo ditë e më tepër ndieja mall për ta parë, për ta dëgjuar... Por... sfida e oqeanit ishte në mes nesh. Ç’të bënim? Ç’mund të*

*bënim? Dhe, a e dinim, në të vërtetë, se çfarë donim të bënim? Ishin pyetje që të gërryenin nëpër anrra.*

*Gati-gati si një somnambul i shkrova kartolinën nga Valencia, në udhëtimin tim të parë në Spanjë, ku shkova të përktheja për disa llafazanë të shoqërisë civile, në një konferencë ku ishte ftuar edhe Gorbaçovi me Raisën e tij. “Cordiales saludos para todos y... un beso a ti, Paloma, si me permites.” E mbajta kartolinën të mbyllur në zarf për katër ditë. E shkrova në Valencia, por e nisa nga Barcelona. “Kush vjen nga Kadizi, shkon në Barcelonë”, m’u kujtua një shprehje spanjolle. Kaloj një muaj, a ndoshta edhe më pak, por mua m’u duk më shumë, dhe, më në fund, erdhi letra e saj. Oh, ç’të shoh?! Fjalë që kurrë nuk i kisha parë e lexuar... “Querido, queridísimo Pedro...” (Nuk u mësua kurrë të më quajë Petro.) Poezia depërtuaka edhe në muret më të ftohta të botës... Poezia po vinte drejt meje, po vinte në krahët e Pablo Nerudës. Sa herë që e kam lexuar dhe përkthyer, gjithnjë e kam ndier Palomën më afër meje. Por kur, kur do të na bashkojë poezia e tij? Los versos más tristes puedo escribir esta noche... Fryn era në ishull. Fryn dhe kalëron. Dëshiron të më çojë larg, shumë larg prej teje...*

*Dymiq, Andresi dhe Karmeni, gazetarë spanjollë që i njoha në ditët e rropamave shqiptare, më rregulluan një bursë të shkoja në Universitetin Komplutense, “të spanjizojë spanjishten time kineze”, siç u shpreh Karmeni, me një buzëqeshje prej shejtaneje andaluze.*

*Kur u nisa për në Madrid, në sytë e mi bashkëlodronin fytyra e Palomës, një fytyrë e imtë që e pashë kur u ndamë para nëntë vjetësh, dhe shpresa se mund të takoheshim në qytetin e dashurisë së përbotshme. Ashtu kisha dëgjuar... nëse Parisi është qyteti i dritës, Madridi e ka dashurinë për dritë.*

*O Zot, si ka mundësi? Si nuk munda ta harroj? Pse e kërkoja kaq larg?! E kisha numrin e telefonit, tashmë, por katër ditë nuk i telefonova, shkoja deri te kabina dhe kthehesha mbrapsht. Pse ta fsheh? Kisha frikë. Frikë nga e panjohura. Por, më në fund, vendosa të përplasem me sfidën oqeanike dhe valët e saj gjigante. Do t'i kapërcenim vallë? Dhe cili, unë apo ajo? Apo të dy bashkë?*

*Pas dy-tri bisedave telefonike, pas letrës dhe një fotografie ku më kishte shkruar: "Buzëqeshja ime, sytë e mi, dashuria ime, për Pedron" gjithçka ndryshoi në fytyrën e Madridit dhe në shpirtin tim. "Do të vij të takohemi në Madrid, më tha në telefon, e mora biletën." Mezi prisja ditën dhe orën kur në aeroportin Barajas, ajo do të zbriste nga një avion i shoqërisë holandeze KLM.*

*Po! Ajo do të vinte. I kisha telefonuar herën e parë katër ditë pasi kisha shkuar në Madrid. M'u deshën katër ditë që të vendosja, ta thërrisja, apo jo? Ndërkohë që mendoja edhe tjetrën; në javën e fundit, me ato pak para që më kishin mbetur nga bursa, të nisesha e të kapërceja vetë oqeanin. Këto mendoja*

kur i bëra telefonatën e dytë dhe, krejt natyrshëm, vetëm prej shpirtit tim, më dolën ato fjalë.

“Po ti, Paloma, pse nuk vjen në Madrid?”

“Kur?”, më pyeti ajo.

“Tani, në javën e fundit të korrikut, ose në fillim të gushtit.”

“Pedro, dejame pensar... lërmë ta mendoj...”

Çfarë ka menduar vallë në ato ditë? Nuk ka menduar. Ka luftuar me Oqeanin Atlantik. Është përvëlur në llavën e vullkanit Cotopaxi. Ka luftuar, më shumë se me gjithçka, me veten e saj. Në letrën e fundit më kishte shkruar që ishte ndarë nga i shoqi, që jeta i kishte rezervuar anën e vet të hidhur. “Por jo, jo, nuk dua të ndahem nga jeta!” Kështu më shkruante. Çfarë mund t'i jap unë në këtë projekt, a kam të paktën një dritare? Dhe unë mendova për herë të parë për një jetë të nesërme. Kur studioja në Kinë gjuhën e Servantesit, mësonim shumë nga thëniet e Konfucit... Kemi dy jetë dhe e dyta fillon atëherë kur e kuptojmë se kemi vetëm një. Ndoshta po më ndodhte edhe mua ashtu, në ato ditë.

Por... Paloma sfidoi gjithçka. Nëna i tha: “Ti je e çmendur! Dy fjalët që të shkroi Pedro, ajo puthje që të ka kërkuar, nuk do të thonë se ai ka rënë në dashuri me ty”. “Do të shkoj, mami...” “Keni një oqean të tërë mes jush, moj bija ime.” “Do të shkoj, mami.”

Por tërmeti ra në zyrën ku punonte.

“Kërkoj lejë. Më ka ftuar një mik në Madrid dhe do të shkoj.”